Hidromorava Gjilan KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT HIDROMORAVA Sh.a.
No. 1483 Data 02.11.2026
GJILAN

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
MINISTRIA E EKONOMISË
MINISTARSTVO EKONOMIJE
MINISTRY OF ECONOMY
Nr. Prot. 01/3 Br. Prot. 2100
Data 02.11.2026

Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Hidromorava" Gjilan
Hidromorava Gjilan

PLANI I BIZNESIT 2027 - 2029



FJALORI I AKRONIMEVE

Shkurtesa	Emërtimi
AKM	Agjencia Kosovare e Metrologjisë
ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
BRrA	Baza Rregullatore e Aseteve
DMA	District Metered Area – Zona të matjes dhe kontrollit të ujërave
FLOWS	Fostering and Leveraging Opportunities for Water Security - Nxitja dhe shfrytëzimi i mundësive për sigurinë e ujit.
FPU	Fabrika për përpunimin e ujit
GIS	Sistemi i Informacionit Gjeografik
ITUZ	Impianti për Trajtimin e Ujërave të Zeza
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjellësit
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
ME	Ministria e Ekonomisë
NJPMNP	Njësia për Politika dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike
O&M	Operimi dhe Mirëmbajtja
PMA	Plani i Menaxhimit të Aseteve
SHUKOS	Shoqata e Ujësjellësve dhe Kanalizimit të Kosovës
UPF	Uji i pafaturuar
UM	Ujëmatës

PËRMBAJTJA

LISTA E TABELAVE v
LISTA E FIGURAVE vii
LISTA E HARTAVE vii
LISTA E GRAFIKËVE vii
1. HYRJE 8
1.1. Historiku i KRU "Hidromorava" Sh.A. 9
1.2. Misioni i Kompanisë 10
1.3. Rreziqet e Kompanisë 10
2. OBJEKTIVAT AFATGJATE STRATEGJIKE TË KOMPANISË 12
2.1. Projeksionet / realizimi nga viti 2025, 2026 dhe parashikimi për vitin 2027 13
3. MASAT PËR REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE 16
3.1. Objektiva e parë – "Sigurimi i burimeve të mjaftueshme të ujit" 16
3.2. Objektiva e dytë – "Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe komerciale të ujit" 16
3.3. Objektiva e tretë – "Arkëtimi i borxheve" 16
3.4. Objektiva e katërt – "Rritja e shkallës së faturimit dhe arkëtimit" 17
4. TARIFAT E SHËRBIMIT 18
5. PLANI I MENAXHIMIT TË ASETEVE 19
6. GJENDJA AKTUALE E PERSONELIT 21
6.1. Struktura kualifikuese e të punësuarve 21
6.1.1. Struktura e moshës së të punësuarve 21
6.2. Nivelet e aftësisë dhe programet e trajnimit 22
6.3. Programet e rekrutimit 23
7. PRODHIMI I UJIT PËR VITIN 2027 27
7.1. Cilësa i ujit të pijshëm në kuadër të zonës së shërbimit 27
7.2. Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit 28
8. SHËRBIMET PËR KONSUMATORË 29
8.1. Të ardhurat nga arkëtimi dhe shpenzimet operative 30
9. PLANI I SHËRBIMIT TË SHITJES 33
9.1. Politikat dhe programet e matjes 33

9.2. Evitimi i lidhjeve ilegale, lidhjeve të konsumatorëve fiktivë dhe lidhjeve pasive 33
9.3. Përditësimi i bazës së konsumatorëve 34
10. PLANI I INVESTIMEVE KAPITALE: 2027-2029 35
11. REKAPITULLIMI I PROJEKTEVE 2027 - 2029 NGA INVESTIMET E KRU HIDROMORAVA/DONATORË 56

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Treguesit e performancës 13
Tabela 2. Planifikimet sipas procesit tarifor 2027 (shprehur në '000 m3 ose '000 euro) krahasimi me vitet 2026/2027 13
Tabela 3. Planifikimet sipas procesit tarifor 2026-2029 (shprehur në '000 m3 ose '000 euro) 14
Tabela 4. Pasqyra e të ardhurave, planifikimi 2026/2027 14
Tabela 5. Performanca nëntë mujore për vitin 2026 (shprehur në "000 m3 ose "000 euro) 15
Tabela 6. Planifikimi i performancës operative për vitin 2027 17
Tabela 7. Tarifat 18
Tabela 8. Gjendja aktuale e personelit 21
Tabela 9. Mosha e të punësuarve 21
Tabela 10. Numri i të punësuarve që do të pensionohen gjatë periudhës 2027-2029 22
Tabela. 11 Rekrutimi i stafit të ri për vitin 2027 dhe 2028 23
Tabela 12. Parashikimi i arkëtimit 30
Tabela 13. Shpenzimet sipas kategorive për vitet 2025, 2026 dhe 2027 31
Tabela 14. Ndërrimi i gypave të ujësjellësit dhe instalimi kyçjeve të reja individuale Gjilan, Viti, Kamenicë 35
Tabela 15. Ndërrimi i gypave të ujërave të ndotura fekale Gjilan, Viti, Kamenicë 36
Tabela 16. Investime në zgjerimin e rrjetit ë ujërave të ndotura fekale 36
Tabela 17. Furnizimi dhe instalimi i manometrave me GPRS - (bartje nga Rishikimi i vitit 2026) 36
Tabela 18. Investimet në Njësinë Operative në Kamenicë 37
Tabela 19. Investime në Divizionin për Planifikim, Zhvillim dhe Menaxhim të Projekteve 37
Tabela 20. Ndërtimi i rrethojave në Stacionet e Pompimit dhe te rezervuarët në nivel regjional. 37
Tabela 21. Përfundimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kyçjet individuale në fshatin Cërnicë (bartje) 38
Tabela 22. Investimi në cilësinë e ujit (investim për periudhën trevjeçare) 38
Tabela 23. Rehabilitimi dhe Modernizimi i Sistemeve të Prodhimit në nivel regjioni 39
Tabela 24. Komunikimi i Stacioneve të Pompimit me rezervuare në zonat rurale 40
Tabela 25. Ndërtimi i depos në Përlepnicë 40
Tabela 26. Ndërtimi i pusetave për zonat DMA 40
Tabela 27. Shtimi i kapacitetit të ujit përmes hulumtimeve të burimeve ujore 40
Tabela 28. Furnizimi dhe instalimi i ujëmatësve të mençur (Smart) 41
Tabela 29. Investime në kyçjet individuale Komuna Gjilan dhe Kamenicë 41
Tabela 30. Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në Komunën e Kllokotit 42
Tabela 31. Investime në rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit në zonat rurale Gjilan dhe Viti 42

Tabela 32. Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit - nivel regjional 42
Tabela 33. Ndërtimi i rrjetit te ujësjellësit në zonat rurale në Komunat Kamenicë dhe Viti 43
Tabela 34. Ndërtimi i kolektorëve në fshatrat Përlepnicë, Dobërçan, Kmetoc, Shillovë 43
Tabela 35. Investime në rrjetin Letnicë - Viti 44
Tabela 36. Furnizimi me ujëmatës, bllokues dhe plomba për ujëmatës (investim për periudhën trevjeçare) 44
Tabela 37. Blerja e pajisjeve fazonerike 44
Tabela 38. Investimet për sanimin e dëmeve të shkaktuara nga kushtet natyrore 45
Tabela 39. Sondë për matjen e parametrave fiziko-kimikë dhe bakteriologjikë 45
Tabela 40. Investime në rehabilitimin dhe funksionimin e stacioneve të pompimit 45
Tabela 41. Investime në sigurinë e burimeve të ujit në zonën e shërbimit që menaxhohen nga KRU "Hidromorava" sh.a. në Gjilan, Viti dhe Kamenicë viti 2023/2024 (të bartura nga viti 2024) 46
Tabela 42. Investimi ne rrjetin e ujësjellësit në Beguncë, Komuna e Vitisë 46
Tabela 43. Investimi në pajisje për detektimin e bllokimeve të rrjetit Kanalizimit (bartura nga 2024) 46
Tabela 44. Investimi në blerjen e mjeteve të vogla të punës 47
Tabela 45. Investimi në siguri në punë 47
Tabela 46. Furnizimi me automjete për nevoja të Kompanisë 47
Tabela 47. Furnizimi me pajisje për detektimin e humbjeve të ujit nga rrjeti i ujësjellësit 48
Tabela 48. Furnizimi me një papuçe vibruese për ngjeshjen e trasesë 48
Tabela 49. Investime në makineri në zonat rurale Gjilan, Viti 48
Tabela 50. Furnizimi me mjete të IT-së 49
Tabela 51. Shërbime profesionale të jashtme për përmbushjen e kërkesave ligjore dhe rregullative 54
Tabela 52. Elaborate për leje ujore 54
Tabela 53. Dokumentacioni për kushte ndërtimore ITUZ 55
Tabela 54. Hartim të projekteve për rrjet të ujësjellësit për investime ndërkombëtare 55
Tabela 55. Rekapitullimi i investimeve vetanake për vitin 2027 56
Tabela 56. Rekapitullimi i investimeve vetanake 2027-2029 56
Tabela 57. Rekapitullimi i investimeve vetanake 2027-2029 56
Tabela 58. Rekapitullimi i investimeve nga donatorët 2026-2026 57

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Organigrami i KRU "Hidrimorava" sh.a. 26
Figura 2. Skema e furnizimit me ujë Gjilan 28

LISTA E HARTAVE

Harta 1. Zona e shërbimit 9
Harta 2. Vlerësimi i Aseteve Nëntokësore 20

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1. Mosha e të punësuarve 21
Grafiku 2. Prodhimi i ujit për vitin 2027 27
Grafiku 3. Shpenzimet sipas viteve 31

1. HYRJE

Plani i Biznesit 2027-2029 përshkruan vizionin strategjik, qëllimet dhe planet e veprimit për tre vitet e ardhshme. Fokusohet në përmirësimin e shërbimeve, sigurimin e qëndrueshmërisë mjedisore dhe përshtatjen ndaj sfidave të brendshme dhe të jashtme, përfshirë ndryshimet klimatike, rritjen e popullsisë dhe ndryshimet rregullatore.

Gjatë hartimit të Planit të Biznesit, rëndësi i kushtohet ndikimit të faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm, përfshirë legjislacionin ekonomik dhe social, strukturën organizative, qeverisjen dhe menaxhimin e riskut.

Objektivat e Kompanisë janë të orientuara drejt shërbimit sa më të mirë, duke ndërtuar strategji dhe identifikuar treguesit kyç të performancës për t'i arritur caqet dhe për ta përmbushur planifikimin.

Në planin e performancës së Kompanisë, burimet njerëzore konsiderohen si një komponent themelor në realizimin e objektivave të saj.

Objektivat financiare përfshijnë uljen e kostos së ofrimit të shërbimeve, duke ofruar efikasitet operacional. Plani ofron një përmbledhje të menaxhimit financiar të biznesit për vitet financiare 2027-2029, duke përfshirë shitjet e ujit dhe të ardhurat e parashikuara, shpenzimet kapitale, performancën buxhetore dhe shpenzimet operative. Në bazë të tarifave të miratuara nga ARRU-ja dhe një vlerësimi paraprak të ponderuar sipas numrit të konsumatorëve, të hyrat nga faturimi vlerësohen rreth 4,479,822 € për vitin 2027. Ky vlerësim përdor si supozim konsum mesatar të njëjtë për konsumatorët e kategorive të ndryshme dhe duhet të përditësohet kur të disponohen vëllimet e faturuara sipas kategorive dhe shërbimeve. Norma e planifikuar e arkëtimit për vitin 2027 mbetet 96.33%, ndërsa shpenzimet operative planifikohen në 3,356,000.00 €.


Aktivitetet kryesore të parapara në Planin Trevjeçar të Biznesit synojnë përmirësimin e efikasitetit operacional dhe arritjen e objektivave strategjikë të Kompanisë në ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë.

Gjatë vitit 2027, Kompania do të synojë rritjen e përqindjes së faturimit të bazuar në leximet faktike të ujëmatësve deri në 100%, përmes digjitalizimit të procesit të leximit dhe faturimit. Për këtë qëllim, planifikohet inicimi i procedurës së prokurimit deri në fund të vitit 2026 për sigurimin dhe implementimin e një aplikacioni mobil, të integruar me sistemin ekzistues të faturimit, me synim që ai të jetë funksional në fillim të vitit 2027.

Aplikacioni do t'u mundësojë lexuesve regjistrimin e drejtpërdrejtë të gjendjes së ujëmatësve në terren dhe bartjen e të dhënave në kohë reale në sistemin e faturimit. Gjithashtu, do të mundësohet gjenerimi i faturës menjëherë pas regjistrimit dhe validimit të leximit, si dhe dërgimi i saj në formë elektronike te konsumatori, sipas mundësive të sistemit. Funksionalitetet shtesë do të përfshijnë fotografimin e ujëmatësit si dëshmi e leximit, identifikimin e lokacionit përmes GPS-it, evidentimin e leximeve të pazakonta dhe ruajtjen e të dhënave në rast të mungesës së internetit, me sinkronizim automatik pas rikthimit të lidhjes.

Zbatimi i këtij sistemi pritet të rrisë saktësinë dhe transparencën e procesit të faturimit, të zvogëlojë gabimet dhe faturimet e bazuara në vlerësime, të përmirësojë kontrollin e punës në terren dhe të kontribuojë në uljen e humbjeve komerciale, rritjen e të hyrave dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve.

Do të përfshihet edhe pastrimi i bazës së të dhënave për konsumatorët joekzistentë.



Harta 1. Zona e shërbimit

1.1. Historiku i KRU "Hidromorava" Sh.A.

Furnizimi me ujë të pijshëm i qytetit të Gjilanit nga ujësjellësi publik filloi rreth vitit 1940, kur u ndërtua kaptazhi i parë pranë fshatit Koretishtë, i cili ndodhet rreth 4 km larg qendrës aktuale të Gjilanit. Me kalimin e kohës, sistemi është rehabilituar, zgjeruar dhe modernizuar vazhdimisht për t'iu përshtatur nevojave në rritje të qytetit.

Në vitin 1971, filloi një projekt për zgjerimin e kapaciteteve të ujit të pijshëm për Gjilanin, i cili përfshinte ndërtimin e një sistemi të ri në pjesën e sipërme të fshatit Përlepnicë, në vendin e quajtur "Guri i Hoxhës", afërsisht 5 km nga fshati. Në vitin 1978, projekti për furnizimin me ujë të pijshëm mori një hap vendimtar me ndërtimin e pendës në Përlepnicë, projekt i cili zgjati deri në fund të vitit 1983. Gjatë kësaj kohe, u ndërtua edhe një fabrikë për pastrimin e ujit të pijshëm, e cila kontribuoi ndjeshëm në përmirësimin e cilësisë së furnizimit.

Pas përfundimit të luftës, në fund të vitit 1999, komuniteti ndërkombëtar, në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës, filloi procesin e riorganizimit të ndërmarrjeve publike. Kjo përfshinte shndërrimin e tyre në kompani publike të menaxhuara sipas standardeve moderne. Fillimisht, u kryen studime mbi gjendjen e ujësjellësve në të gjithë Kosovën dhe më pas, në bashkëpunim me partnerë të shumtë ndërkombëtarë, filloi riorganizimi dhe rimëkëmbja e tyre. Si rezultat, u themeluan shtatë Kompani Rajonale të Ujësjellësit dhe të Kanalizimit për të mbuluar të gjitha rajonet e Kosovës.

Në juglindje të Kosovës, në procesin e riorganizimit të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Hidromorava", një rol kyç pati Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Swiss Agency for Development and Cooperation – SDC), e cila ofroi mbështetje të vazhdueshme për të ndihmuar në rimëkëmbjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të kësaj Kompanie. Ky partneritet kontribuoi në ndërtimin e kapaciteteve dhe përmirësimin e shërbimeve për komunitetin, duke siguruar furnizim të qëndrueshëm dhe me cilësi të lartë me ujë të pijshëm për qytetarët e Gjilanit dhe zonat përreth.

1.2. Misioni i Kompanisë

Misioni i Kompanisë është të sigurojë furnizim të qëndrueshëm, të sigurt dhe me cilësi të lartë të ujit të pijshëm për të gjithë konsumatorët e saj, në përputhje të plotë me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të shëndetit dhe sigurisë. Kompania angazhohet të ofrojë ujë të mjaftueshëm dhe të cilësisë së duhur për çdo përdorues të lidhur në sistem, pa dallim race, gjinie apo besimi fetar, duke e konsideruar këtë një të drejtë themelore për të gjithë dhe duke respektuar parimin e mosdiskriminimit në ofrimin e shërbimeve.

Në përputhje me këtë, Kompania synon të ofrojë shërbime cilësore në grumbullimin, trajtimin dhe shkarkimin e ujërave të ndotura, duke mbrojtur shëndetin publik dhe duke përmbushur standardet më të larta të mbrojtjes së mjedisit. Duke trajtuar dhe shkarkuar ujërat e ndotura në mënyrë të sigurt, Kompania përpiqet të kontribuojë në ruajtjen e mjedisit dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës për të gjithë komunitetin të cilit i shërben.

Për më tepër, Kompania synon të përmirësojë vazhdimisht performancën e saj financiare, për të arritur një qëndrueshmëri financiare.. Objektivi është të sigurohet që Kompania të ketë likuiditetin e nevojshëm për të mbuluar shpenzimet operacionale dhe për të përmbushur nevojat e saj për investime kapitale. Përmes përmirësimit të vazhdueshëm të gjendjes financiare, Kompania synon të jetë e aftë të tërheqë financime shtesë, përfshirë edhe kredinë, për të investuar në përmirësimin dhe zgjerimin e infrastrukturës, duke garantuar kështu një zhvillim të qëndrueshëm për të ardhmen.

Këto përpjekje kolektive ndihmojnë në realizimin e vizionit të Kompanisë për të qenë një ofrues i besueshëm i shërbimeve të ujit dhe kanalizimit, që kontribuon në mirëqenien e komunitetit dhe në mbrojtjen e burimeve ujore.


1.3. Rreziqet e Kompanisë

Realizimi i misionit të Kompanisë për sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm dhe cilësor të ujit mund të hasë në një sërë rreziqesh të natyrave të ndryshme, të cilat mund të ndikojnë në aftësinë për të përmbushur objektivat e saj. Disa nga këto rreziqe përfshijnë:

- Mungesa e ujit për shkak të rrezikut të thatësirave: Në kushtet e ndryshimeve klimatike, reshjet atmosferike janë bërë më të paparashikueshme dhe shpesh të pamjaftueshme. Kjo mund të çojë në mungesa të konsiderueshme të burimeve ujore, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në kapacitetin e furnizimit të Kompanisë.
- Kriza socio-ekonomike në nivel kombëtar ose lokal: Në rast të një krize ekonomike, mund të ketë ndikime të ndjeshme në aftësinë e konsumatorëve për të paguar faturat e ujit, si dhe në buxhetet e disponueshme për mirëmbajtje dhe investime. Një krizë e tillë mund të ulë edhe të ardhurat e Kompanisë, duke kufizuar mundësitë për përmirësim dhe zgjerim të infrastrukturës.
- Shfaqja e pandemive që ndikon në të ardhurat: Pandemitë si COVID - 19 mund të shkaktojnë ndërprerje të konsiderueshme në aktivitetet ekonomike dhe sociale, duke ndikuar negativisht në të ardhurat e Kompanisë si rezultat i mosrealizimit të pagesave dhe uljes së konsumit. Pandemitë mund të çojnë gjithashtu në kosto shtesë për ruajtjen e sigurisë dhe shëndetit të stafit.

- Mungesa e gatishmërisë së donatorëve për të financuar projektet investive: Nëse donatorët ndërkombëtarë dhe organizatat financiare nuk janë të gatshëm të mbështesin projektet e nevojshme investive, kjo mund të ndikojë negativisht në mundësinë e Kompanisë për të modernizuar dhe zgjeruar shërbimet e saj. Financimi i jashtëm është shpesh thelbësor për projektet e mëdha kapitale që kërkohen për të përmirësuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e furnizimit me ujë.
- Fatkeqësitë natyrore të papritura: Fenomene si tërmetet, përmbytjet, thatësira e zgjatur, apo rrëshqitjet e tokës mund të shkaktojnë dëmtime të konsiderueshme në infrastrukturën e ujësjellësit dhe kanalizimit. Fatkeqësitë natyrore jo vetëm që sjellin kosto të larta për riparime dhe rehabilitimin e aseteve, por gjithashtu rrezikojnë ndërprerjen e furnizimit me ujë dhe shkarkimin e ujërave të ndotura.

Përballja me këto rreziqe kërkon një planifikim të kujdesshëm dhe qasje proaktive. Kompania angazhohet të ndërmarrë masa të duhura për të zvogëluar ndikimin e këtyre rreziqeve, duke përfshirë përdorimin e teknologjive të përparuara, zhvillimin e planeve të reagimit të shpejtë, si dhe bashkëpunimin me institucione dhe partnerë të jashtëm për të siguruar qëndrueshmërinë e shërbimeve në çdo rrethanë.



2. OBJEKTIVAT AFATGJATE STRATEGJIKE TË KOMPANISË

KRU "Hidromorava" Sh.A. përfshin Qendrën Rajonale në Gjilan dhe dy njësi operative në Viti dhe Kamenicë. Kompania funksionon duke respektuar parimet e qeverisjes korporative, me vendimmarrje dhe llogaridhënie të rregullt ndaj Bordit të Drejtorëve dhe Njësisë për Politika dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë. Këto struktura sigurojnë mbikëqyrje dhe drejtim të vazhdueshëm të Kompanisë, duke mundësuar realizimin e qëllimit për ofrimin e shërbimeve cilësore për konsumatorët e saj.

Bordi i Drejtorëve, në bashkëpunim me Menaxhmentin, ka përcaktuar një sërë objektivash strategjikë për ta udhëhequr KRU "Hidromorava" sh.a. drejt një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm për periudhën 2027-2029. Objektivat kryesorë përfshijnë:

a) Sigurimi i burimeve të mjaftueshme të ujit në zonën e shërbimit: KRU "Hidromorava" sh.a. synon të përmirësojë kapacitetet e furnizimit me ujë për të plotësuar nevojat në rritje të zonës së shërbimit, duke investuar në burime të reja dhe në menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ekzistuese.

b) Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe komerciale: Duke përmirësuar infrastrukturën dhe duke zbatuar teknologji moderne për monitorimin e rrjedhave dhe menaxhimin e presionit, Kompania synon të reduktojë humbjet e ujit dhe të maksimizojë efikasitetin operativ. Njëkohësisht, përmes identifikimit dhe regjistrimit të saktë të të gjithë konsumatorëve, si dhe sigurimit të leximit të rregullt të ujëmatësve dhe faturimit të saktë dhe në kohë të ujit të konsumuar, synohet zvogëlimi i humbjeve komerciale dhe përmirësimi i performancës financiare të Kompanisë.

c) Arkëtimi i borxheve të vjetra: Për të përmirësuar stabilitetin financiar, KRU "Hidromorava" sh.a. do të zbatojë strategji efektive për arkëtimin e borxheve të vjetra, duke përdorur qasje proaktive dhe mjete të avancuara të menaxhimit të borxhit.

d) Rritja e shkallës së faturimit dhe arkëtimit: Për të siguruar të ardhura të qëndrueshme dhe për të mbuluar shpenzimet operacionale, Kompania do të përmirësojë proceset e faturimit dhe të arkëtimit, duke angazhuar staf të trajnuar dhe teknologji të përditësuar.

e) Avancimi i sistemit informativ gjeografik (GIS):KRU "Hidromorava" sh.a. do të vazhdojë përmirësimin e sistemit GIS për të mbuluar tërë zonën e shërbimit, duke mundësuar monitorim më të detajuar dhe planifikim efektiv të aseteve. Ky proces do të përfshijë gjithashtu hartimin dhe implementimin e një Plani të Menaxhimit të Aseteve.

f) Mirëmbajtja e rregullt e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit: Me qëllim të garantimit të cilësisë së shërbimeve, Kompania do të vazhdojë programin e mirëmbajtjes së rregullt të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, duke përfshirë inspektime të shpeshta dhe riparime të menjëhershme për të shmangur ndërprerjet e shërbimit.

g) Përputhja me Rregulloret e ARRU-së:KRU "Hidromorava" do të respektoj plotësisht rregulloret e rekomanduara nga ARRU, përfshirë Standardet Minimale të Shërbimeve, Licencimin, Kartën e Konsumatorëve dhe Politikat Tarifore. Ky angazhim siguron që shërbimet të ofrohen me cilësi të lartë dhe në përputhje me normat rregullatore.

h) Rritja e transparencës në raportim:Kompania do të përmirësojë transparencën në raportimet që u ofrohen Bordit të Drejtorëve dhe palëve të tjera të interesuara, duke siguruar informacione të sakta dhe të përditësuara për performancën dhe projektet e saj.

i) Rritja e vetëqëndrueshmërisë financiare:Në përpjekje për të forcuar qëndrueshmërinë financiare, Kompania do të rrisë normën e mbulimit të punës për të siguruar që mundësitë për investime të jenë në rritje dhe që financat të mbeten të qëndrueshme në periudhën afatgjatë.

j) Rritja e vlerës së aseteve për periudhën 2027-2029: Përmes investimeve të donatorëve, qeverisë dhe burimeve vetanake, Kompania synon të rrisë vlerën e aseteve të saj, duke kontribuar kështu në forcimin e infrastrukturës dhe në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve që ofron.

Këto qëllime strategjike përcaktojnë një rrugë të qartë për zhvillimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të KRU "Hidromorava" sh.a., me fokus në ofrimin e shërbimeve të cilësisë së lartë dhe në përmbushjen e nevojave të komunitetit të cilit i shërben.

Për realizimin e objektivave kryesorë strategjikë për periudhën 2027-2029, Kompania ka paraparë përmbushjen e treguesve në vijim, të përcaktuar në koordinim me ARRU:

Tabela 1. Treguesit e performancës

Treguesit kryesor të performancës	Njësia	2025	2026	2027	2028	2029
Ujë i pafaturuar - si përqindje	%	54.30	53.06	47.59	42.60	42.16
Norma e arkëtimit - e përgjithshme	%	100.19	95.77	96.33	96.10	96.00
Norma e arkëtimit - amvisëritë	%	97.15	96.00	96.00	96.00	96.00
Norma e arkëtimit - biznese	%	98.00	98.00	98.00	98.00	97.00
Norma e arkëtimit - institucione	%	98.00	100.00	100.00	100.00	100.00
Norma e mbulesës së punës	Numër	1.22	1.24	1.21	1.20	1.19
Përqindja e konsumatorëve me lexim	%	99.78	99.86	99.92	100.00	100.00
Staf për 1000 konsumatorë	Numër	4.46	4.36	4.46	4.60	4.65

2.1. Projeksionet / realizimi nga viti 2025, 2026 dhe parashikimi për vitin 2027

Tabela 2. Planifikimet sipas procesit tarifor 2027 (shprehur në '000 m3 ose '000 euro) krahasimi me vitet 2026/2027

Nr	Treguesi	X 1000 m^3 ose X 1000 €[1]			Plani i rritjes në %
		2025	2026	2027	2027
1.	Prodhimi i ujit (m^3)	9,270	9,500	9,700	102.11
2.	Faturimi i ujit (m^3)	4,236	4,459	5,084	114.02
3.	Uji i pafaturuar (m^3)	5,034	5,041	4,616	91.57
4.	Faturimi €	2,803	3,954	4,480	113.30
5.	Arkëtimi €	2,919	3,707	4,315	116.41
6.	Përqindja e arkëtimit (%)	104.13	93.76	96.33	102.74
7.	Shpenzimet (€)	2,476	2,800	3,356	119.86
8.	Numri i konsumatorëve të regjistruar (aktiv/pasiv)	46,711	48,440	50,233	103.70
9.	Konsumatorë aktiv (numër)	42,678	43,900	45,640	103.96
10.	Konsumatorë me UM (numër)	42,533	43,839	45,576	103.96

11.	Konsumatorë me UM (%)	99.66	99.86	99.86	100.00
12.	Përqindja e ujit të faturuar	45.70	46.94	52.41	111.65
13.	Përqindja e ujit të pa faturuar (humbja)	54.30	53.06	47.59	89.69
14.	Norma e mbulimit të punës (4/7)	1.13	1.32	1.21	91.67

Tabela 3. Planifikimet sipas procesit tarifor 2026-2029 (shprehur në '000 m3 ose '000 euro)

Nr	Treguesi	X 1000 m^3 ose X 1000 €[1]			
		2026	2027	2028	2029
1	Prodhimi i ujit (m^3)	9,500	9,700	9,755	9,768
2	Faturimi i ujit (m^3)	4,459	5,084	5,497	5,650
3	Uji i pafaturuar (m^3)	5,041	4,616	4,258	4,118
4	Faturimi €	3,954	4,480	4,762	4,873
5	Arkëtimi €	3,707	4,315	4,576	4,678
6	Përqindja e arkëtimit (%)	93.75	96.33	96.10	96.00
7	Shpenzimet (€)	2,800	3,356	3,601	3,710
8	Nr. i konsumatorëve të regjistruar (aktiv /pasiv)	48,440	51,233	53,494	54,950
9	Konsumatorë aktiv (numër)	43,900	45,640	49,461	51,934
10	Konsumatorë me ujëmatës (numër)	43,839	45,576	49,397	51,866
11	Konsumatorë me ujëmatës (%)	99.86	99.86	99.87	99.87
12	Përqindja e ujit të faturuar	46.94	52.41	56.33	57.84
13	Përqindja e ujit të pa faturuar (humbja)	53.06	47.59	43.67	42.16
14	Norma e mbulimit të punës (4/7)	1.32	1.21	1.25	1.27

Tabela 4. Pasqyra e të ardhurave, planifikimi 2026/2027

	Realizimi janar – shtator 2026	Realiizmi dhe planifikimi 2026	Planifikimi 2027
Të hyrat nga faturimi	2,910,086.00	382,0986.00	4,440,308.00
Të hyrat e tjera	27,063.00	31,080.00	39,692.00
Gjithsej të ardhurat	**2,937,149**	**3,852,066.00**	4,480,000.00
Kategorizimi i shpenzimeve			
Ngarkesa për shërbime ndaj, ARRU, MMPH, SHUKOS	-27,885.00	-49,180.00	-54,500.00
Shpenzimet e materialit dhe të materieve të konsumueshme	-12,593.00	-16,791.00	-85,400.00
Shpenzimet e shërbimeve të kontraktuara	-40,908.00	-54,544.00	-80,500.00
Shpenzimet e energjisë elektrike	-456,438.00	-608,584.00	-695,400.00

Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe të riparimit	-40,709.00	-54,279.00	-81,500.00
Shpenzimet e derivateve	-35,474.00	-47,299.00	-60,600.00
Shpenzimet e pagave	-1,476,430.00	-1,919,359.00	-2,225,600.00
Shpenzimet tjera direkte dhe indirekte	-80,602.00	-50,500	-72,500.00
Gjithsej shpenzimet operative	**2,171,039.00**	**2,800,535**	**3,356,000.00**
Shpenzimet e provizionimit (borxh i keq/vendimet e gjykatave)	-5,530.00	-5,530.00	-7,000,.00
Shpenzimet e zhvlerësimit	-1,081,142.00	-1,081,142.00	-1,190,000.00
Të hyrat nga grantet	646,735.00	646,735.00	700,000.00
Shpenzimet e provizionimit (borxh i keq)			
Fitimi i planifikuar	**326,173.00**	611,594.00	627,000.00

Tabela 5. Performanca nëntë mujore për vitin 2026 (shprehur në "000 m3 ose "000 euro)

Nr	Performanca e KRU "Hidromorava" sh.a.-Gjilan X1000 m3 dhe X1000 €	Realizimi janar-shtator 2026	Plani janar-shtator 2026	Realizimi i planit nëntë mujor 2026 në %
1	Prodhimi i ujit m^3	7,237,522	6,821,000	106.11
2	Faturimi i ujit m^3	3,344,975	3,607,000	92.74
3	Uji i pafaturuar (humbja)	3,892,547	3,214,000	121.11
4	Faturimi €	2,965,618	3,009,675	98.54
5	Arkëtimi €	2,780,537	2,942,450	94.50
6	Përqindja e arkëtimit (%)	93.76%	96.39%	97.27%
7	Shpenzimet €	2,171,039	2,314,976	93.78
8	Konsumatorë të regjistruar (numër)	48,015	48,452	99.10
9	Konsumatorë aktivë (numër)	43,485	44,423	97.89
10	Konsumatorë me ujëmatës (numër)	43,365	44,293	97.90
11	Përqindja e konsumatorëve me ujëmatës	99.72%	99.71	100.01
12	Përqindja e ujit të faturuar	46.22	52.56	87.94
13	Përqindja e ujit të pa faturuar (humbja)	53.78	47.44	113.36
14	Norma e mbulimit të punës	1.28	1.27	100.70

3. MASAT PËR REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE

3.1. Objektiva e parë – "Sigurimi i burimeve të mjaftueshme të ujit"

Sa i përket objektivit të parë, "Sigurimi i burimeve të mjaftueshme të ujit", Kompania nuk ka kapacitete të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për realizimin e këtij objektivi me burimet e veta financiare. Për arritjen e tij, Kompania do të mbështetet në burime të jashtme financimi, përfshirë institucionet qeveritare dhe kontributet e donatorëve. Në këtë drejtim, Qeveria e Republikës së Kosovës është duke punuar në dy drejtime, ndër të cilat përfshihet:

- **Projekti për ndërtimin e digës së Firajës**, me qëllim të sigurimit të ujit për rajonet e Gjilanit, Ferizajt dhe Prishtinës, i financuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

3.2. Objektiva e dytë – "Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe komerciale të ujit"

Humbjet e ujit paraqesin një sfidë kyçe për Kompaninë, ndërsa viti 2027 përbën një periudhë të rëndësishme për arritjen e cakut të zvogëlimit të ujit të pafaturuar (UPF) në nivelin prej 47.59%, të përcaktuar nga Autoriteti Rregullator për Ujërat (ARRU).

Kompania do të vazhdojë të përqendrohet në identifikimin e lidhjeve të paautorizuara, parandalimin e keqpërdorimeve, instalimin e ujëmatësve zonalë dhe zbatimin e masave për uljen e humbjeve teknike dhe komerciale. Në këtë drejtim, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet verifikimit dhe përditësimit të të dhënave të konsumatorëve, identifikimit të konsumit të pafaturuar dhe konsumatorëve të paregjistruar, kontrollit të saktësisë së ujëmatësve, përmirësimit të proceseve të leximit dhe faturimit, si dhe forcimit të mekanizmave për arkëtimin e borxheve. Përmes këtyre aktiviteteve, Kompania synon të rrisë sasinë e ujit të faturuar, të përmirësojë realizimin e të hyrave dhe të sigurojë menaxhim më efikas e të qëndrueshëm të sistemit të furnizimit me ujë, në përputhje me kërkesat rregullatore në fuqi.

3.3. Objektiva e tretë – "Arkëtimi i borxheve"

Arkëtimi i borxheve përbën një objektiv themelor për menaxhimin financiar të Kompanisë. Numri i konsumatorëve që kanë obligime të papaguara ndaj Kompanisë, me borxh individual në vlerë prej së paku 100.00 €, është mbi 8,700, ndërsa vlera e përgjithshme e borxhit të tyre arrin në 5,529,994.00 €. Aktivitetet për menaxhimin dhe arkëtimin e këtyre borxheve do të vazhdojnë të realizohen sipas një plani veprimi, i cili përfshin:

Telefonatat: Kompania ka nisur një fushatë intensive gjatë viteve 2023, 2024, 2025 dhe 2026, e cila do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2027, me qëllim të njoftimit të konsumatorëve për borxhet e tyre dhe arritjes së marrëveshjeve për pagesë. Ky aktivitet ka rezultuar i suksesshëm, pasi deri më tani janë arritur marrëveshje me rreth 2,443 konsumatorë, me një vlerë që tejkalon 2,100,000.00 €, kryesisht për borxhe më të vjetra se një vit.

Vërejtjet: Kjo masë përfshin dërgimin e njoftimeve zyrtare për informimin e konsumatorëve lidhur me borxhet e tyre dhe pasojat në rast të mospagesës në afatin e përcaktuar.

Shkyçjet: Gjatë vitit 2027, do të shtohen tri ekipe të reja, secila e përbërë nga dy anëtarë, duke e rritur në gjashtë numrin e përgjithshëm të ekipeve aktive. Këto ekipe do të ndahen në gjashtë zona specifike, ku secili ekip do të jetë përgjegjës për zonën përkatëse. Në rastet kur konsumatorët nuk reagojnë ndaj vërejtjeve dhe nuk i kryejnë pagesat, do të ndërmerren masa për shkyçjen e tyre nga shërbimi.

Procedurat përmbarimore: Për të siguruar arkëtimin e borxheve nga konsumatorët që nuk i përmbushin detyrimet për shërbimet e ofruara, do të iniciohen procedurat përmbarimore. Qëllimi është arritja e marrëveshjeve për pagesë dhe mundësimi i një menaxhimi më efikas të këtyre detyrimeve.

Paditë penale: Në rastet kur masat e lartpërmendura nuk japin rezultat, do të ndiqen procedurat ligjore përmes gjykatave, me qëllim të kërkimit të përmbushjes së detyrimeve të papaguara.

3.4. Objektiva e katërt - "Rritja e shkallës së faturimit dhe arkëtimit"

- Plani i arkëtimit për vitin 2027 parasheh arkëtimin e 96.33% të ujit të faturuar. Ky synim pritet të arrihet përmes mobilizimit të të gjithë stafit, veçanërisht të ekipeve për shkyçjen e konsumatorëve që nuk i përmbushin detyrimet për ujin e konsumuar. Plani i arkëtimit do të përfshijë përdorimin e metodave të ndryshme për organizimin dhe realizimin e arkëtimit të mjeteve.
- Kompania do të zbatojë masa më të rrepta në rastet kur konsumatorët nuk i kryejnë pagesat e tyre, me fokus të veçantë në kategoritë e konsumatorëve shtëpiakë (amvisëritë), bizneset e vogla dhe institucionet.
- Në përpjekje për të adresuar sfidat e arkëtimit, Kompania do të zbatojë një qasje të veçantë ndaj kategorisë së konsumatorëve shtëpiakë, me qëllim të trajtimit të problemeve që lidhen me mospagesën e ujit të konsumuar, përmes masave të mëposhtme:
- Përmirësimi i sistemeve të monitorimit dhe të pagesës së konsumit të ujit;
- Zbatimi i një politike më të rreptë për pagesën e borxheve të vonuara;
- Ndërmarrja e fushatave informuese për konsumatorët lidhur me rëndësinë e pagesës me kohë të ujit të konsumuar.

Tabela 6. Planifikimi i performancës operative për vitin 2027

Treguesit Operativ	Plan Biznesi 2027
Prodhimi i ujit në m^3	9,700,000.00
Faturimi i ujit (%)	52.41
Arkëtimi i ujit (%)	96.33
Uji i pafaturuar (%)	47.59
Testet e dështuara (%)	-
Konsumatorë me Ujëmatës (%)	99.86
Numri i konsumatorëve të regjistruar	50,233
Numri i punëtorëve	190

4. TARIFAT E SHËRBIMIT

Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Hidromorava" sh.a. zbaton tarifat e përcaktuara nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU). Në bazë të tarifave aktuale dhe duke marrë në konsideratë nivelin e prodhimit, shkallën e arkëtimit, si dhe nivelin e humbjeve komerciale dhe teknike, mundësohet mbulimi i plotë i kostove operative. Për vlerësimin paraprak të të hyrave për vitet 2027-2029 është përdorur një rritje orientuese prej 6.06%, e llogaritur duke ponderuar tarifat kumulative sipas numrit të konsumatorëve dhe duke supozuar konsum mesatar të njëjtë. Ky vlerësim duhet të përditësohet kur të disponohen vëllimet e faturuara sipas kategorive dhe shërbimeve; nuk paraqet llogaritje të saktë të të hyrave. Tarifat fikse mujore për vitin 2027 paraqiten sipas diametrit të kyçjes, në përputhje me vendimin e ARRU-së; ndikimi i tyre financiar nuk është llogaritur veçmas, pasi mungon numri i kyçjeve sipas diametrit.

Tabela 7. Tarifat

		2025	2026	2027
Shtëpiak - tarifa fikse mujore	EUR/kons/muaj	1	1.25	1.3830
Shtëpiak - volumetrike	EUR/m³	0.39	0.5463	0.5591
Komercial - industrial-tarifa fikse mujore	EUR/kons/muaj	2	2	2.2127
Komercial - industrial-volumetrike	EUR/m³	0.55	0.7101	0.6709
Institucional - tarifa fikse mujore	EUR/kons/muaj	2	2	2.2127
Institucional - volumetrike	EUR/m³	0.55	0.7101	0.6709
Ujërat e ndotura (vëllimi i ujit të konsumuar)				
Shtëpiak	EUR/m³	0.12	0.1463	0.1784
Komercial - industrial	EUR/m³	0.27	0.3218	0.3925
Institucional	EUR/ m³	0.27	0.3218	0.3925
Tarifat kumulative				
Shtëpiak (ujë dhe ujëra të ndotura)	EUR/ m³	0.51	0.6926	0.7375
Jo - shtëpiak (ujë dhe ujëra të ndotura)	EUR/ m³	0.82	1.0319	1.0634

5. PLANI I MENAXHIMIT TË ASETEVE

Plani për Menaxhimin e Aseteve (PMA) përfshin vlerësimin e aseteve nëntokësore dhe mbitokësore, duke përfshirë kategori të ndryshme të aseteve, si strukturat ndërtimore (ndërtesat e stacioneve të pompimit dhe rezervuarët), pompat, valvulat, veturat, pajisjet elektrike, pjesët e tjera më të imta, si dhe rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit. Aktualisht, asetet janë vlerësuar në katër kategori, për të cilat janë përcaktuar shërbyeshmëria (gjendja dhe performanca) dhe kritikaliteti (gjendja kritike e asetit, pasojat dhe dështimet). Në fund, është bërë renditja e aseteve më kritike. Kjo listë duhet të shërbejë edhe si listë prioritare për hartimin e planit të investimeve. Lista gjendet në pjesën e investimeve të këtij dokumenti.

Vlerësimi i aseteve të infrastrukturës nëntokësore, përkatësisht i rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit, është realizuar përmes modelit ModelBuilder1, si proces i automatizuar përmes sistemit GIS. Për të realizuar një vlerësim sa më të saktë dhe të automatizuar, në përputhje me kërkesat e rregullatorit, është përdorur një metodologji e bazuar në kriteret e mëposhtme:

1. Materiali i gypave: Është realizuar vlerësimi i materialit të gypave, nga AC deri te HDPE RC.
2. Diametri i gypave: Është realizuar vlerësimi i diametrit të gypave sipas rëndësisë, ku diametri më i madh paraqet rëndësi më të madhe.
3. Viti i instalimit të gypave: Është analizuar mosha e gypave dhe shkalla e amortizimit të tyre, duke marrë parasysh jetëgjatësinë.
4. Numri i defekteve në gyp: Është analizuar numri i defekteve në gyp, bazuar në të dhënat që disponohen.

Në bazë të këtyre kritereve, është ndërtuar modeli i automatizuar, i cili mundëson paraqitjen në kohë reale të të dhënave të kërkuara. Në hartën e mëposhtme janë paraqitur gypat e gjeneruar nga modeli. Kritikaliteti është paraqitur me ngjyra, në gjashtë rangje të paracaktuara, ku rangu më i lartë paraqet gjendjen më kritike dhe më të padëshiruar, e cila paraqitet me ngjyrë të kuqe (në faqen pasuese).



[1] ModelBuilder është një gjuhë programimi vizuale që përdoret për menaxhimin e të dhënave përmes automatizimit të proceseve gjeohapësinore.



Harta 2. Vlerësimi i Aseteve Nëntokësore

6. GJENDJA AKTUALE E PERSONELIT

6.1. Struktura kualifikuese e të punësuarve

Përbërja e stafit të Kompanisë sipas njësive operative (Gjilan, Viti dhe Kamenicë), të ndarë në tri departamente: teknik, financiar dhe administratë, si dhe sipas nivelit të arsimimit, paraqitet në tabelën e mëposhtme. Numri i përgjithshëm i të punësuarve është 173, prej të cilëve 148 janë meshkuj dhe 25 janë femra.

Tabela 8. Gjendja aktuale e personelit

Niveli arsimor	Gjilan	Viti	Kamenicë	Totali
Master	12	0	2	14
Fakulteti/Bachelor	26	2	2	30
Arsimi i mesëm	78	17	13	108
Arsimi fillor	19	0	2	21
Totali	**135**	**19**	**19**	**173**
Meshkuj (M)	148			
Femra (F)	25			

6.1.1. Struktura e moshës së të punësuarve

Bazuar në të dhënat e fundit mbi strukturën e moshës së punonjësve në KRU "Hidromorava" sh.a., deri në fund të shtatorit 2026, siç paraqitet në tabelën e mëposhtme, pjesa më e madhe e stafit i përket grupmoshës 50-59 vjeç, e cila përbën 35% të numrit të përgjithshëm të punonjësve. Kjo tregon se një pjesë e konsiderueshme e stafit ka përvojë të gjatë profesionale, por njëkohësisht nënvizon rëndësinë e planifikimit të përtëritjes së stafit dhe përfshirjes së brezave të rinj në vitet në vijim.

Tabela 9. Mosha e të punësuarve

Mosha e punëtorëve	Numri i Punëtorëve	Përqindja
20-29	1	0.58%
30-39	26	15.03%
40-49	46	26.59%
50-59	61	35.26%
60-65	39	22.54%
Totali	**173**	**100%**



Grafiku 1. Mosha e të punësuarve

6.1.2. Numri i të punësuarve që do të pensionohen gjatë periudhës 2027-2029

Tabela 10. Numri i të punësuarve që do të pensionohen gjatë periudhës 2027-2029

Pozita	**Viti 2027**
Zyrtar i kontabilitetit analitik dhe financiar	1
Mjeshtër i rrjetit të ujësjellësit	1
Mjeshtër i rrjetit të ujësjellësit - NjO. Kamenicë	1
Mjeshtër i rrjetit të kanalizimit	1
Laborante kryesore për analizat fiziko-kimike	1
Rojtar - FPU Përlepnicë	2
Operator në Fabrikën e përpunimit të ujit (FPU) dhe stacione të pompimit në Velekincë	1
Operator - FPU Letnicë (NjO Viti)	1
Mjeshtër i rrjetit të kanalizimit (Nj.O. Kamenicë)	1
Total	**10**
Pozita	**Viti 2028**
Mjeshtër i rrjetit të ujësjellësit	1
Zyrtar për regjistrim dhe kontroll të automjeteve	1
Punëtor fizik në rrjet të ujësjellësit	1
Lexues i ujëmatësve dhe shpërndarës i faturave – NjO. Viti	1
Operator - FPU Letnicë (NjO. Viti)	1
Total	**5**
Pozita	**Viti 2029**
Operator në Fabrikën e përpunimit të ujit (FPU) dhe stacione të pompimit	2
Teknik për kontroll dhe shkyçje të lidhjeve të paautorizuara dhe ujit të pafaturuar	1
Faturist – Regjistrim i inventarit - NjO. Kamenicë	1
Teknik për mirëmbajtje dhe kontroll të klorit – NjO. Kamenicë	1
Total	**5**

6.2. Nivelet e aftësisë dhe programet e trajnimit

Riorganizimi i punës, transferimi i punëtorëve në shërbime të planifikuara dhe ndryshimet e vazhdueshme strukturore, të cilat synojnë rritjen e fleksibilitetit në punë dhe përshtatjen me mjedisin e punës, janë tregues që dëshmojnë rëndësinë e trajnimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm të stafit, me ndikim pozitiv në rritjen e efikasitetit të KRU "Hidromorava" sh.a. Përmes këtij procesi synohet përmirësimi i aftësive dhe ngritja e kualifikimit profesional të punëtorëve, duke marrë parasysh specifikat e secilës punë.

KRU "Hidromorava" sh.a. do të organizojë në nivel të Kompanisë trajnime të vazhdueshme për punëtorët brenda sektorëve,

të cilat do të udhëhiqen nga përgjegjësit e sektorëve dhe drejtuesit e departamenteve.
Gjithashtu, është paraparë pjesëmarrja në trajnime për ngritjen profesionale të stafit të shërbimeve financiare dhe teknike, të organizuara nga Shoqata e Ujësjellësve dhe Kanalizimit të Kosovës, ashtu siç është vepruar edhe më parë. Nevojat për trajnime janë të theksuara si në nivel të Menaxhmentit, ashtu edhe në sektorët financiarë, teknikë, të prokurimit dhe administrativë.
Gjatë vitit 2027, do të shqyrtohen mundësitë për organizimin e trajnimeve në fusha të ndryshme, si: menaxhimi modern i burimeve njerëzore, menaxhimi financiar, GIS-i, mirëmbajtja e rrjetit të furnizimit me ujë, reduktimi i humbjeve në rrjet, menaxhimi i sistemit informativ, si dhe trajnime të tjera.

6.3. Programet e rekrutimit

Suksesi dhe përshtatshmëria e një kompanie, ndër të tjera, varen edhe nga rekrutimi i punonjësve profesionalë dhe të përkushtuar në punë. Për këtë arsye, KRU "Hidromorava" sh.a. parasheh rekrutimin e punonjësve të nevojshëm për sektorët përkatës, duke marrë parasysh rritjen e numrit të konsumatorëve dhe vëllimit të punëve.
Menaxhmenti i Kompanisë vlerëson se kapacitetet profesionale të burimeve njerëzore ende nuk janë në nivelin e kërkuar. Për këtë arsye, nevojat për përmirësimin e tyre do të adresohen gjatë periudhës planifikuese 2027-2029. Gjithashtu, në bazë të Ligjit për Financat Publike, kërkohet plotësimi i pozitës së Certifikuesit të Pagesave, e cila është e domosdoshme për garantimin e sigurisë në ekzekutimin e pagesave dhe për përmbushjen e kritereve të zbatimit të projekteve të planifikuara për tri vitet e ardhshme, siç janë projekti FLOWS dhe ndërtimi i Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Ndotura.
Aktualisht, Kompania ka një normë të mbulimit me punonjës prej 3,99 për 1.000 konsumatorë aktivë. Deri në fund të vitit 2027, Menaxhmenti parasheh plotësimin e strukturës organizative, duke i kushtuar rëndësi të veçantë forcimit të kontrollit në terren, leximit të ujëmatësve dhe kapaciteteve të sektorit të shkyçjes, me qëllim të rritjes së arkëtimit dhe të të ardhurave të Kompanisë. Duke u bazuar në planet për zgjerimin e zonës së shërbimit dhe fillimin e ndërtimit të Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Ndotura, Kompania parasheh rekrutimin e punonjësve të rinj gjatë periudhës planifikuese, sipas paraqitjes në tabelën e mëposhtme.

Tabela. 11 Rekrutimi i stafit të ri për vitin 2027 dhe 2028

Pozita	Viti 2027
Zyrtar për certifikim të pagesave	1
Laborant për analizat mikrobiologjike	1
Inxhinier i elektroteknikës në Divizionin e Prodhimit	1
Inxhinier për planifikim dhe zhvillim	1
Vozitës i autocisternës dhe makinerive të rënda (vozitës i ekskavatori)	1
Mjeshtër i rrjetit të ujësjellësit	1
Përgjegjës i operativës NJO Viti	1
Shef i kontabilitetit	1
Lexues/NJO Viti	1
Mirëmbajtëse/Pastruese Nj.O. Kamenicë/Viti	2
Punëtor i sigurimit në objektin e administratës së KRU "Hidromorava" sh.a.	1
Punëtor i pakualifikuar/Punëtor fizik	2
Zyrtar për siguri kibernetike	1
Zyrtar për IT	1
Total	**16**

Pozita	Viti 2028
Drejtor Komercial	1
Zyrtar për raportim	1
Punëtor i pakualifikuar/Punëtor fizik	3
Zyrtar i kontabilitetit analitik	1
Lexues ujëmatësve dhe shpërndarës i faturave	4
Menaxher i Divizionit të Impiantit të trajtimit të ujërave të Ndotura (ITUN)	1
Total	**11**

Pozita	Viti 2029
Inxhinier mekanik në Impiantin e trajtimit të ujërave të Ndotura (ITUN)	1
Inxhinier elektrik në Impiantin e trajtimit të ujërave të Ndotura (ITUN)	1
Kimist në Impiantin e trajtimit të ujërave të Ndotura (ITUN)	1
Mekanik në Impiantin e trajtimit të ujërave të Ndotura (ITUN)	2
Elektricist në Impiantin e trajtimit të ujërave të Ndotura (ITUN)	2
Operator në Impiantin e trajtimit të ujërave të Ndotura (ITUN)	4
Vozitës i autocisternës dhe makinerive të rënda në Impiantin e trajtimit të ujërave të Ndotura (ITUN)	1
Total	**12**

Koha dhe dinamika e rekrutimit për periudhën 2027-2029 do të përcaktohen në bazë të progresit të aktiviteteve, nevojave operative dhe gjendjes financiare të Kompanisë.

Për vitin 2027, prioritet do t'i jepet plotësimit të pozitave në fushën e financave, certifikimit të pagesave, analizave mikrobiologjike, inxhinierisë, planifikimit dhe zhvillimit, si dhe pozitave operative për mirëmbajtjen e rrjetit dhe ofrimin e shërbimeve në njësitë operative.

Për vitin 2028, planifikohet plotësimi i pozitave në menaxhimin komercial, raportim, kontabilitet analitik, leximin e ujëmatësve dhe shpërndarjen e faturave, si dhe përgatitja e kapaciteteve njerëzore për funksionalizimin e Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (ITUN). Ndërsa, për vitin 2029, parashihet rekrutimi i stafit teknik dhe operativ të nevojshëm për funksionimin e këtij impianti.

Plotësimi i pozitave do të bëhet në përputhje me nevojat reale të Kompanisë, me synim rritjen e efikasitetit operacional, përmirësimin e mirëmbajtjes së rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimit, zgjerimin e zonës së shërbimit dhe përmirësimin e performancës në faturim. Në këtë kuadër, për vitin 2028 janë planifikuar edhe katër punonjës shtesë për leximin e ujëmatësve dhe shpërndarjen e faturave, me qëllim mbështetjen e zgjerimit të shërbimeve dhe përmbushjen e objektivave të faturimit.

KRU "Hidromorava" sh.a. ka hartuar organogramin në përputhje me strategjinë zhvillimore dhe nevojat funksionale të Kompanisë, duke përcaktuar qartë pozitat, rolet dhe përgjegjësitë organizative. Zbatimi i kësaj strukture synon përmirësimin e menaxhimit, shfrytëzimin më efikas të burimeve njerëzore dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve. Koha dhe dinamika e rekrutimit për periudhën 2027-2029 do të përcaktohen në bazë të progresit të aktiviteteve, nevojave operative dhe gjendjes financiare të Kompanisë.

Për vitin 2027, prioritet do t'i jepet plotësimit të pozitave në fushën e financave, certifikimit të pagesave, analizave mikrobiologjike, inxhinierisë, planifikimit dhe zhvillimit, si dhe pozitave operative për mirëmbajtjen e rrjetit dhe ofrimin e shërbimeve në njësitë operative.

Për vitin 2028, planifikohet plotësimi i pozitave në menaxhimin komercial, raportim, kontabilitet analitik, leximin e ujëmatësve dhe shpërndarjen e faturave, si dhe përgatitja e kapaciteteve njerëzore për funksionalizimin e Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (ITUN). Ndërsa, për vitin 2029, parashihet rekrutimi i stafit teknik dhe operativ të nevojshëm për funksionimin e këtij impianti.

Plotësimi i pozitave do të bëhet në përputhje me nevojat reale të Kompanisë, me synim rritjen e efikasitetit operacional, përmirësimin e mirëmbajtjes së rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimit, zgjerimin e zonës së shërbimit dhe përmirësimin e performancës në faturim. Në këtë kuadër, për vitin 2028 janë planifikuar edhe katër punonjës shtesë për leximin e ujëmatësve dhe shpërndarjen e faturave, me qëllim mbështetjen e zgjerimit të shërbimeve dhe përmbushjen e objektivave të faturimit.

KRU "Hidromorava" sh.a. ka hartuar organogramin në përputhje me strategjinë zhvillimore dhe nevojat funksionale të Kompanisë, duke përcaktuar qartë pozitat, rolet dhe përgjegjësitë organizative. Zbatimi i kësaj strukture synon përmirësimin e menaxhimit, shfrytëzimin më efikas të burimeve njerëzore dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve.






Figura 1. Organigrami i KRU "Hidrimorava" sh.a.

7. PRODHIMI I UJIT PËR VITIN 2027

Prodhimi i planifikuar për vitin 2027 është 9,700,000 m^3, që nënkupton një mesatare aritmetike prej rreth 808,333 m^3 në muaj. Sipas Tabelës së performancës për periudhën janar-shtator 2026, prodhimi i realizuar ishte 7,237,522 m^3, ose mesatarisht rreth 804,169 m^3 në muaj. Për arritjen e objektivit vjetor 2027 kërkohet një rritje mesatare prej rreth 4,164 m^3 në muaj (afërsisht 0.52%) krahasuar me mesataren e realizuar në nëntë muajt e parë të vitit 2026. Shpërndarja mujore përfundimtare duhet të pasqyrojë sezonalitetin, kapacitetet e burimeve dhe planin operativ të Kompanisë. Për të përmbushur kërkesën e pritshme, Kompania do të synojë uljen e humbjeve, në mënyrë që një pjesë më e madhe e ujit të prodhuar të shpërndahet dhe faturohet.



Grafiku 2. Prodhimi i ujit për vitin 2027

Shënim: UAF llogaritet si prodhimi minus faturimi; përqindjet e ujit të faturuar dhe të pafaturuar janë llogaritur nga këto vëllime.

7.1. Cilësa i ujit të pijshëm në kuadër të zonës së shërbimit

Cilësia e ujit të pijshëm të shpërndarë në të gjithë zonën e shërbimit monitorohet rregullisht nga ekipet e specializuara të KRU "Hidromorava" sh.a. në Gjilan, si dhe nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK).

Në impiantet e trajtimit të ujit në Përlepnicë, Velekincë dhe Letnicë janë të instaluara pajisje për monitorimin online të parametrave kryesorë të cilësisë së ujit. Gjatë vitit 2027, Kompania planifikon të investojë në rehabilitimin e këtyre pajisjeve, pasi disa prej tyre nuk janë funksionale, ndërsa të tjerat kanë nevojë për kalibrim.

Gjatë periudhës 2027-2029, Kompania planifikon të ndërmarrë masa të mëtejshme për përmirësimin e cilësisë së ujit të pijshëm, me synim arritjen e shkallës 100% të përmbushjes së standardeve të përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës.

KRU "Hidromorava" sh.a. vazhdon zbatimin e Planit Operacional për Menaxhimin e Cilësisë së Ujit, të miratuar nga Qendra e Ujit në kuadër të IKSHPK-së. Gjithashtu, është përfunduar edhe "Plani për Sigurinë e Ujit dhe Menaxhimin e Krizave", zbatimi i të cilit do të bëhet në përputhje me kërkesat e Autoritetit Rregullator.

7.2. Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit

Krahas aktiviteteve të tjera, Kompania kujdeset për grumbullimin dhe largimin e ujërave të ndotura nga qytetet e Gjilanit, Vitisë dhe Kamenicës, përmes rrjeteve të kanalizimit dhe kolektorëve kryesorë, pa trajtim paraprak para shkarkimit në mjedis.

Ujërat e ndotura të qytetit të Gjilanit shkarkohen në lumin Morava përmes dy kolektorëve kryesorë. Ujërat e ndotura të qytetit të Vitisë shkarkohen në të njëjtin lumë përmes kolektorit kryesor, ndërsa ato të qytetit të Kamenicës shkarkohen në lumin Krivareka përmes kolektorit përkatës.




Figura 2. Skema e furnizimit me ujë Gjilan

Në periudhën e ardhshme, Kompania do t'i kushtojë rëndësi të veçantë sektorit të kanalizimit, si në aspektin e investimeve, ashtu edhe në atë të organizimit të punës, me qëllim të rritjes së efikasitetit të këtij sektori. Aktivitetet që pritet të realizohen nga ekipet përgjegjëse përfshijnë:

a) Inspektimin e pusetave të kanalizimit;
b) Riparimin e pusetave të kanalizimit;
c) Zhbllokimin dhe pastrimin e rrjetit të kanalizimit.

8. SHËRBIMET PËR KONSUMATORË

Numri i konsumatorëve aktivë deri në shtator të vitit 2026 është 43,485, duke shënuar një rritje prej 1.299 konsumatorësh krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kjo rritje pritet të vazhdojë edhe gjatë vitit 2027, si rezultat i zgjerimit të zonës së shërbimit.

Gjatë periudhës planifikuese, Kompania synon rritjen e numrit të konsumatorëve të rinj, me ç'rast deri në fund të vitit 2027 parashihet të arrihet numri prej 45,640 konsumatorësh aktivë. Gjatë këtij viti, identifikimi i konsumatorëve ilegalë pritet të bëhet më i lehtë dhe më efikas përmes funksionalizimit të plotë të sistemit GIS (Sistemi i Informacionit Gjeografik). Përdorimi i GIS-it nga lexuesit e ujëmatësve dhe personeli i terrenit do të mundësojë identifikimin e të gjithë përdoruesve të ujit të pijshëm nga rrjeti i ujësjellësit, si dhe lehtësimin e inspektimit të kyçjeve të paautorizuara në rrjet. Gjithashtu, planifikohet inspektimi i konsumatorëve me konsum zero, me qëllim të verifikimit të gjendjes faktike dhe identifikimit të arsyeve për mungesën e konsumit të regjistruar.

Synimi kryesor i Kompanisë për periudhën 2027-2029 është përmirësimi i cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve, duke përfshirë saktësinë në leximin e ujëmatësve dhe shpërndarjen e faturave, funksionalizimin e Call Center-it, si dhe ofrimin e shërbimeve të sakta dhe efikase.

Në kuadër të procesit të leximit të ujëmatësve, në bashkëpunim me Zyrën e GIS-it, është testuar një aplikacion pilot për dërgimin nga terreni të fotografive të ujëmatësve, së bashku me lokacionin dhe shënimet shtesë. Rezultatet e këtij testimi kanë qenë shumë pozitive, pasi është mbuluar pothuajse e gjithë zona e shërbimit dhe janë siguruar të dhëna reale për gjendjen e ujëmatësve. Ky proces ka zvogëluar mundësitë për manipulime gjatë leximit dhe ka rritur transparencën. Megjithëse aplikacioni kërkon zhvillim të mëtejshëm, projekti pilot ka krijuar bazën dhe përvojën e nevojshme për përmirësimin e performancës operative dhe reduktimin e humbjeve komerciale.

Për vitin 2027, parashihet zhvillimi i një aplikacioni të avancuar për leximin e ujëmatësve nga distanca, i cili do të përfshijë funksione për printimin dhe gjenerimin e faturave në kohë reale, si dhe mundësinë e funksionimit pa lidhje interneti (offline).

Gjithashtu, planifikohet zhvillimi i një aplikacioni për pagesën online të faturave, raportimin e defekteve, komunikimin me Call Center-in dhe ofrimin e shërbimeve të tjera digjitale, me qëllim që konsumatorët të mund t'i kryejnë shërbimet e nevojshme pa pasur nevojë të paraqiten fizikisht në zyrat e Kompanisë.

Gjatë vitit 2027, planifikohet edhe shpërndarja e kontratave të shërbimit për të gjithë konsumatorët, me synim forcimin e bashkëpunimit dhe formalizimin e plotë të marrëdhënieve ndërmjet Kompanisë dhe konsumatorëve.

Objektivat kryesore të Divizionit për Konsumatorë për periudhën 2027-2029 janë:

- Sigurimi i leximit të saktë dhe të rregullt të të gjithë ujëmatësve, në përputhje me rregulloret e ARRU-së;
- Rritja e numrit të konsumatorëve përmes identifikimit të kyçjeve ilegale;
- Rritja e numrit të kontratave të shërbimit me konsumatorët;
- Zvogëlimi i numrit të ankesave për çështje komerciale;
- Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve.

Gjatë procesit të shkyçjeve, do të respektohen rregulloret e Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU). Në rastet kur paraqitet nevoja, Kompania do të kërkojë mbështetjen e Policisë së Kosovës për të siguruar zhvillimin e rregullt të procesit. Konsumatorët që pengojnë realizimin e shkyçjes teknike do të procedohen në rrugë ligjore.

Kompania synon përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve ndaj konsumatorëve, duke garantuar transparencë dhe

bashkëpunim me të gjithë akterët e sektorit të ujit. Shërbimi i Marrëdhënieve me Konsumatorë do të vazhdojë të përmirësojë veprimtarinë e tij, veçanërisht përmes regjistrimit dhe raportimit elektronik të ankesave, si dhe shqyrtimit dhe trajtimit efikas të tyre brenda afateve kohore të përcaktuara.

8.1. Të ardhurat nga arkëtimi dhe shpenzimet operative

Për vitin 2027, arkëtimi nga shitja e ujit planifikohet të arrijë vlerën prej 4,315,413.00 €, që përfaqëson 96.33% të vlerës së planifikuar të faturimit për këtë vit. Realizimi i këtij objektivi do të mbështetet në vazhdimin e masave për rritjen e efikasitetit të arkëtimit, përmirësimin e proceseve të faturimit dhe intensifikimin e aktiviteteve për mbledhjen e borxheve të papaguara nga periudhat paraprake.

Në këtë drejtim, rëndësi e veçantë do t'i kushtohet rritjes së saktësisë së leximit të ujëmatësve dhe faturimit sipas konsumit faktik të konsumatorëve, me synim zvogëlimin e mospërputhjeve ndërmjet konsumit të realizuar dhe vlerave të faturuara. Përmes kontrolleve në terren do të vazhdojë identifikimi i lidhjeve të paautorizuara dhe të dyfishta, si dhe evidentimi i rasteve të manipulimit me ujëmatës. Rastet e tilla do të trajtohen përmes procedurave përkatëse administrative dhe ligjore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për përmirësimin e mëtejshëm të arkëtimit, Kompania do të intensifikojë aktivitetet e ekipeve të shkyçjes, duke u fokusuar në konsumatorët me obligime të papaguara dhe në zbatimin e masave përkatëse pas njoftimeve dhe paralajmërimeve. Gjithashtu, do të vazhdojë njoftimi i konsumatorëve për borxhet e tyre, promovimi i marrëveshjeve për shlyerjen e obligimeve me këste, kur plotësohen kushtet përkatëse, si dhe inicimi i procedurave të përmbarimit për rastet që i plotësojnë kushtet ligjore.

Në rritjen e arkëtimit do të kontribuojë edhe lehtësimi i mundësive të pagesës përmes arkave të Kompanisë, institucioneve mikrofinanciare, llogarive bankare dhe kanaleve të tjera të autorizuara të pagesës. Njëkohësisht, do të bëhet përcjellja e vazhdueshme e realizimit të arkëtimit dhe krahasimi i rezultateve me objektivat e planifikuara, me qëllim identifikimin në kohë të devijimeve dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese.

Përqindja e planifikuar e arkëtimit prej 96.33% përfaqëson objektivin vjetor ndaj faturimit të planifikuar. Arkëtimi i borxheve të periudhave paraprake do të kontribuojë në përmirësimin e qarkullimit financiar dhe në forcimin e likuiditetit të Kompanisë, duke u përcjellë veçmas nga arkëtimi i faturimit të vitit aktual, për të siguruar paraqitje të saktë dhe transparente të rezultateve financiare.

Tabela 12. Parashikimi i arkëtimit

		2026	2027	2028	2029
Shtëpiak	% e arkëtimit	96.00%	95.00%	95.00%	95.00%
Komercial - industrial	% e arkëtimit	100.00%	98.00%	95.50%	98.00%
Institucional	% e arkëtimit	100.00%	98.00%	98.00%	100.00%
Norma e përgjithshme	% e arkëtimit	96.39%	96.33%	96.10%	96.00%

Tabela 13. Shpenzimet sipas kategorive për vitet 2025, 2026 dhe 2027


Shpenzimet operative	2025	2026	2027
Ngarkesa për shërbime ndaj ARRU, MMPH, SHUKOS	42,496.00	49180.00	54,500.00
Shpenzimet e materialit dhe materieve të konsumueshme	76,692.00	16,791.00	85,400.00
Shpenzimet e shërbimeve të kontraktuara	45,848.00	54,544.00	80,500.00
Shpenzimet e energjisë	485,000.00	608,584.00	695,400.00
Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit	77,362.00	54,279.00	81,500.00
Shpenzimet e derivateve	35,758.00	47,299.00	60,600.00
Shpenzimet e personelit	1,653,701.00	1,919,359.00	2,225,600.00
Shpenzimet tjera direkte dhe indirekte	29,540.00	50,500.00	72,500.00
Total	**2,446,397.00**	**2,800,535.00**	**3,356,000.00**



Grafiku 3. Shpenzimet sipas viteve

Nga grafiku i paraqitur më lart vërehet një rritje e shpenzimeve në secilin vit të periudhës së planifikimit. Kjo rritje lidhet me zgjerimin e zonës së shërbimit dhe marrjen në menaxhim të zonave të reja rurale, si rezultat i vazhdimit të projekteve të financuara nga donatorët, Komuna e Gjilanit dhe e Kamenicës, të cilat ndikojnë në rritjen e shpenzimeve operative të Kompanisë.

Rritja vërehet veçanërisht te shpenzimet që ndikojnë drejtpërdrejt në kostot e prodhimit dhe të distribuimit të ujit. Meqenëse shumica e sistemeve funksionojnë përmes pompimit, ato paraqesin kosto të larta operative dhe të mirëmbajtjes, veçanërisht për shkak të konsumit të energjisë elektrike. Për më tepër, rritja e vazhdueshme e çmimeve të energjisë elektrike dhe të derivateve të naftës ndikon drejtpërdrejt në rritjen e kostove operative të Kompanisë. Për rrjedhojë, zgjerimi i zonës së shërbimit dhe vënia në funksion e sistemeve të reja, krahas rritjes së çmimeve të inputeve kryesore, ndikojnë në rritjen e përgjithshme të shpenzimeve operative dhe të kategorive të tjera të shpenzimeve të Kompanisë.



9. PLANI I SHËRBIMIT TË SHITJES

9.1. Politikat dhe programet e matjes

Gjatë vitit 2027, Kompania do të zbatojë një plan të strukturuar të veprimit për rritjen e arkëtimit nga shitja e ujit dhe ofrimi i shërbimeve të tjera, me fokus në zvogëlimin e borxheve të konsumatorëve dhe përmirësimin e disiplinës së pagesave. Plani do të përfshijë këto masa konkrete:

- Dërgimi i vërejtjeve për borxhet e papaguara: Lexuesit e ujëmatësve dhe ekipet e shkyçjes do t'u dorëzojnë konsumatorëve vërejtje për obligimet e papaguara, duke i njoftuar për shumën e borxhit dhe afatin për pagesë.
- Kontaktimi telefonik i konsumatorëve: Konsumatorët me borxhe në vlerë prej 50 € deri në 100 € do të kontaktohen përmes telefonit dhe do të ftohen t'i shlyejnë obligimet e papaguara brenda një afati të përcaktuar.
- Identifikimi dhe prioritizimi i borxhlinjve: Do të përgatiten lista periodike të konsumatorëve me borxhe, të ndara sipas vlerës dhe kohëzgjatjes së borxhit, me qëllim të përcaktimit të prioriteteve për arkëtim.
- Marrëveshjet për shlyerjen e borxheve: Për konsumatorët që kanë vështirësi në shlyerjen e obligimeve, do të shqyrtohet mundësia e lidhjes së marrëveshjeve për pagesë me këste, në përputhje me procedurat dhe politikat e miratuara të Kompanisë.
- Zbatimi i masave të shkyçjes: Për konsumatorët që nuk i përmbushin obligimet e tyre pas njoftimeve përkatëse, do të ndërmerren procedurat për shkyçje individuale dhe, kur është e arsyeshme dhe e zbatueshme, shkyçje kolektive, në përputhje me Rregulloren Nr. 18/2026 për Ndërprerjen dhe Rilidhjen e Shërbimeve të Ujit në Kosovë.
- Procedimi i borxheve në përmbarim: Për konsumatorët që nuk i shlyejnë obligimet dhe ndaj të cilëve janë plotësuar kushtet ligjore, do të iniciohen procedurat përkatëse për dërgimin e lëndëve në përmbarim, duke respektuar kërkesat ligjore dhe procedurale.
- Kontrolli i rezultateve të arkëtimit: Do të bëhet përcjellja periodike e rezultateve të këtyre masave, përmes krahasimit të borxheve fillestare me pagesat e realizuara, numrit të konsumatorëve të kontaktuar, vërejtjeve të dërguara dhe lëndëve të proceduara në përmbarim.

Paralelisht, Kompania do të vazhdojë identifikimin e lidhjeve të paautorizuara, trajtimin e rasteve të heqjes së paautorizuar të plombave dhe parandalimin e konsumit të pafaturuar. Të gjitha veprimet do të realizohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret përkatëse të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit, me synim rritjen e arkëtimit, zvogëlimin e borxheve dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare të Kompanisë.

Gjatë vitit 2027, Kompania do të vazhdojë të inkurajojë konsumatorët që pagesat t'i kryejnë në pikat e arkëtimit të Kompanisë, me qëllim të menaxhimit më efikas të shpenzimeve që lidhen me tarifat e paguara pranë institucioneve mikrofinanciare. Njëkohësisht, synohet forcimi i komunikimit me konsumatorët përmes përditësimit të rregullt të të dhënave dhe ripërtëritjes së kontratave të shërbimit. Gjithashtu, planifikohet zhvillimi i një aplikacioni për pagesa online dhe përditësimi i bazës së të dhënave të konsumatorëve, me qëllim përmirësimin e menaxhimit të borxheve dhe të performancës së sektorit të shitjes.

9.2. Evitimi i lidhjeve ilegale, lidhjeve të konsumatorëve fiktivë dhe lidhjeve pasive

Identifikimi i kyçjeve ilegale do të realizohet në bazë të informatave të siguruara nga punonjësit e Kompanisë, përkatësisht lexuesit e ujëmatësve gjatë punës në terren, përmes përdorimit të komparatorëve për identifikimin e kyçjeve të paautorizuara, inspektimeve në zonat ku evidentohen nivele të rritura të humbjeve të ujit, si dhe njoftimeve të pranuara nga

vetë konsumatorët, përfshirë ata që deri më tani kanë qenë të kyçur ilegalisht në rrjet.

Gjatë vitit 2027, për identifikimin e konsumatorëve ilegalë do të vazhdojë përdorimi i sistemit GIS, përmes zhvillimit të aplikacioneve të bazuara në GIS, në platformën softuerike ESRI ArcGIS Server Enterprise Standard. Këto aplikacione do të mundësojnë lokalizimin e konsumatorëve të kyçur në mënyrë të paautorizuar në rrjetin e ujësjellësit, si dhe identifikimin dhe kontrollin më të lehtë e më të shpejtë të rasteve të rikyçjes së paautorizuar pas shkyçjes. Qasja në këto aplikacione do t'u mundësohet lexuesve të ujëmatësve në zonat përkatëse dhe ekipit të shkyçjes, me qëllim të rritjes së efikasitetit të kontrolleve në terren.

Gjithashtu, gjatë vitit 2027, Kompania do t'i kushtojë vëmendje të veçantë identifikimit dhe verifikimit të konsumatorëve fiktivë, për të cilët dyshohet se janë të evidentuar në sistemin e faturimit pa pasur një lidhje reale dhe të veçantë të furnizimit me ujë, apo që mund të jenë regjistruar si konsumatorë të veçantë, ndonëse furnizohen përmes së njëjtës lidhje fizike. Këto raste mund të kenë ardhur si rezultat i regjistrimeve jo të sakta ndër vite, ndryshimeve në evidencat e konsumatorëve apo mospërputhjeve ndërmjet gjendjes faktike në terren dhe të dhënave në sistemin e faturimit. Për këtë qëllim, do të realizohen kontrolle dhe verifikime në terren, duke krahasuar të dhënat e sistemit të faturimit me gjendjen faktike të furnizimit, me synim identifikimin e këtyre rasteve dhe harmonizimin e evidencave të konsumatorëve.

9.3. Përditësimi i bazës së konsumatorëve

Përditësimi i bazës së të dhënave të konsumatorëve nënkupton identifikimin, evidentimin dhe regjistrimin e të gjithë konsumatorëve në tërë zonën e shërbimit të Kompanisë.

Për realizimin e këtij synimi, janë planifikuar aktivitetet në vijim:

- Incizimi në terren i kyçjevetë konsumatorëve shtëpiakë dhe i ujëmatësve nga ekipet e Kompanisë;
- Përditësimi sistematik i bazës së të dhënavetë konsumatorëve nga Njësia e GIS-it, bazuar në të dhënat e mbledhura dhe të evidentuara në terren;
- Verifikimi i të gjitha rasteve të konsumatorëve që aktualisht nuk identifikohen në terren, nuk faturohen ose kanë kyçje të dyfishta. Për këtë qëllim, Kompania planifikon formimin e një komisioni, i cili do të shqyrtojë dhe verifikojë rastet përkatëse, si dhe do të hartojë raport me gjetjet nga terreni dhe rezultatet e verifikimit.



10. PLANI I INVESTIMEVE KAPITALE: 2027-2029

Projektpropozimet për investime në infrastrukturë për periudhën 2027-2029 kanë rëndësi të veçantë për KRU "Hidromorava" sh.a., veçanërisht në drejtim të zvogëlimit të humbjeve të ujit, të cilat gjatë periudhës nëntëmujore të vitit 2026 kanë qenë rreth 53% e sasisë së përgjithshme të ujit të prodhuar. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre humbjeve shkaktohet nga amortizimi i rrjetit të ujësjellësit, i cili në shumë raste është më i vjetër se 45 vjet. Pjesët e rrjetit të propozuara për zëvendësim janë kryesisht të ndërtuara nga gypa prej azbest-çimentoje ose zinku.

Investimet kapitale për vitin 2027, të përcaktuara në kuadër të procesit të përcaktimit të tarifave të ujit, përfshijnë kategoritë në vijim:

- Përtëritja e infrastrukturës së ujit të pijshëm: 226.790,00 €;
- Mirëmbajtja kapitale e aseteve joinfrastrukturore për shërbimin e ujit të pijshëm: 110.500,00 €;
- Zgjerimi i aseteve joinfrastrukturore për shërbimin e ujit të pijshëm: 20.000,00 €;
- Mirëmbajtja e aseteve joinfrastrukturore për aktivitetet biznesore: 92.000,00 €;
- Përtëritja e infrastrukturës për grumbullimin e ujërave të ndotura: 117.503,00€;
- Zgjerimi i infrastrukturës për ujërat e ndotura: 50.000,00 €.

Tabela 14. Ndërrimi i gypave të ujësjellësit dhe instalimi kyçjeve të reja individuale Gjilan, Viti, Kamenicë

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Ndërrimi i gypave të ujësjellësit dhe instalimi kyçjeve te reja individuale Gjilan, Viti, Kamenicë sipas PMA-së 2027	235,000.00	Vetanake	100%	235,000.00	0%		2027
Ndërrimi i gypave të ujësjellësit dhe instalimi kyçjeve te reja individuale Gjilan, Viti, Kamenicë sipas PMA-së 2028	455,000.00	Vetanake	100%	455,000.00	0%		2028
Ndërrimi i gypave të ujësjellësit dhe instalimi kyçjeve te reja individuale Gjilan, Viti, Kamenicë sipas PMA-së 2029	460,000.00	Vetanake	100%	460,000.00	0%		2029
Totali:	**1,150,000.00**			**1,150,000.00**			

Tabela 15. Ndërrimi i gypave të ujërave të ndotura fekale Gjilan, Viti, Kamenicë

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Ndërrimi i gypave të ujërave të ndotura fekale Gjilan, Viti, Kamenicë sipas PMA-së 2027	135,000.00	Vetanake	100%	135,000.00	0%		2027
Ndërrimi i gypave të ujërave të ndotura fekale Gjilan, Viti, Kamenicë sipas PMA-së 2028	150,000.00	Vetanake	100%	150,000.00	0%		2028
Ndërrimi i gypave të ujërave të ndotura fekale Gjilan, Viti, Kamenicë sipas PMA-së 2029	150,000.00	Vetanake	100%	150,000.00	0%		2029
Totali:	**435,000.00**			**435,000.00**			

Tabela 16. Investime në zgjerimin e rrjetit të ujërave të ndotura fekale

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Ndërtimi i kanalizimit në zonën e shërbimit	50,000.00	Vetanake	100%	50,000.00	0%		2027
Zëvendësimi i pusetave të vjetra në zonën urbane	2,000.00	Vetanake	100%	2,000.00	0%		2027
Totali:	**52,000.00**			**52,000.00**			

Tabela 17. Furnizimi dhe instalimi i manometrave me GPRS - (bartje nga Rishikimi i vitit 2026)

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit	Vlera në €	Përqindja e Financimit	Vlera në €	Viti Investimit
Furnizimi dhe instalimi i manometrave me teknologji GPRS në të gjithë zonën e shërbimit	130,000.00	Vetanak	100%	130,000.00	0%		2027
Totali:	**130,000.00**			**130,000.00**			

Tabela 18. Investimet në Njësinë Operative në Kamenicë

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Ndërtimi i rezervuarit me V=250 -300 m^3 te Stacioni i Pompimit Nr.1	100,000.00	Vetanake	50%	50,000	50%	50,000	2027
Kalimi i kyçjeve individuale në Berivojcë, Kamenicë	200,000.00	Vetanake, Komuna e Kamenicë, Donatorët	10%	20,000.00	90%	180,000.00	2027
Totali:	**300,000.00**			**120,000.00**		**180,000.00**	

Tabela 19. Investime në Divizionin për Planifikim, Zhvillim dhe Menaxhim të Projekteve

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Licencë për Utility Network Analyst (për ArcGIS Pro)	7,500.00	Vetanake	100%	7,500.00	0%		2027
Dron UAV për monitorimin e kyçjeve ilegale dhe detektimin e humbjeve të ujit	20,000.00	Vetanake	100%	20,000.00	0%		2027
Totali:	**27,500.00**			**27,500.00**			

Tabela 20. Ndërtimi i rrethojave në Stacionet e Pompimit dhe te rezervuarët në nivel regjional.

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Rrethoja në Stacionet e Pompimit dhe rezervuarëve në nivel regjioni (investim tre vjeçar)	60,000.00	Vetanake	100%	60,000.00	0%		2027-2029
Totali:	**60,000.00**			**60,000.00**			

Tabela 21. Përfundimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kyçjet individuale në fshatin Cërnicë (bartje)

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Përfundimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Cërnicë (gypi shtytës me gjatësi 4,7 km, ndërrimi i lokacionit të puseve dhe projektimi), si dhe realizimi i kyçjeve individuale	470,000.00	Vetanake dhe donatorë	57%	267,900.00	43%	202,100.00	2027-2028
Totali:	**470,000.00**			**267,900.00**		**202,100.00**	

Tabela 22. Investimi në cilësinë e ujit (investim për periudhën trevjeçare)

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Filtera dhe zbutës të ujit për STP Novobërdë, Sadovinë dhe Pozhoran	20,000.00	Vetanake	100%	20,000.00	0%		2027-2029
Pompa dozuese të alumin sulfatit dhe pompave për hipoklorit	18,000.00	Vetanake	100%	18,000.00	0%		2027-2029
Izolimi i pusit në Makresh	15,000.00	Vetanake	100%	15,000.00	0%		2027-2029
Bombola për klor të gazët (15 copë)	15,000.00	Vetanake	100%	15,000.00	0%		2027-2029
Instrumente për matjen e PH klorit dhe turbullirës në FPU Përlepnicë	12,000.00	Vetanake	100%	12,000.00	0%		2027-2029
Dehumudifikatorë (tharëse e ajrit) për FPU Velekincë	26,000.00	Vetanake	100%	26,000.00	0%		2027-2029
Totali:	**106,000.00**			**106,000.00**			

Tabela 23. Rehabilitimi dhe Modernizimi i Sistemeve të Prodhimit në nivel regjioni

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Ndërrimi i sistemit SCADA (Moduleve, PLC dhe PC-ve) FPU Përlepnicë	350,000.00	Qeveria, Donatorët	0%	0.00	100%	350,000.00	2028-2029
Modifikimet ne sistemin SCADA dhe ndërrimi i pajisjeve në ITU Velekincë (bartje nga 2026)	200,000.00	Vetanak	100%	200,000.00	0%	0.00	2027
Rehabilitimi i ITU-së në FPU në Letnicë (FPU ekzistuese)	160,000.00	Qeveria, Donatorët	50%	80,000.00	50%	80,000.00	2028-2029
Investimi në mirëmbajtje të pajisjeve elektromekanike dhe module të sistemit SCADA	50,000.00	Vetanake	100%	50,000.00	0%	0.00	2027-2028
Furnizimi dhe instalimi i pompave elektrike zhytëse dhe centrifugale në nivel regjioni	95,000.00	Vetanake	100%	95,000.00	0%	0.00	2027-2029
Sigurimi dhe furnizimi me VFD (frekuentorë) si pjesë rezervë në nivel regjioni	35,000.00	Vetanake	100%	35,000.00	0%	0.00	2027-2028
Investimi në ndërrimin e akuatorëve (valvulave) FPU Letnicë (9 copë)	60,000.00	Qeveria, Donatorët	0%	0.00	100%	60,000.00	2027-2028
Totali:	**950,000.00**			**460,000.00**		**490,000.00**	

Tabela 24. Komunikimi i Stacioneve të Pompimit me rezervuare në zonat rurale

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Komunikimi i Stacioneve të Pompimit me rezervuare në zonat rurale	40,000.00	Vetanak	100%	40,000.00	0%		2027-2029
Totali:	**40,000.00**			**40,000.00**			

Tabela 25. Ndërtimi i depos në Përlepnicë

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Ndërtimi i një depoje për sistemimin e pjesëve fazonike, pompave dhe pajisjeve të tjera në Përlepnicë	60,000.00	Vetanak	100%	60,000.00	0%		2027-2029
Totali:	**60,000.00**			**60,000.00**			

Tabela 26. Ndërtimi i pusetave për zonat DMA

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Ndërtimi i pusetave të ujësjellësit për krijimin e zonave DMA në Gjilan dhe Kamenicë	285,000.00	Qeveria, Donatorët	0%	0.00	100%	285,000.00	2028-2029
Totali:	**285,000.00**			**0.00**		**285,000.00**	

Tabela 27. Shtimi i kapacitetit të ujit përmes hulumtimeve të burimeve ujore

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit

Shtimi i kapacitetit të ujit përmes hulumtimeve të burimeve ujore në Gjilan, Viti dhe Kamenicë	210,000.00	Vetanake, Komuna e Gjilan, Viti, Kamenicë, Qeveria	10%	21,000.00	90%	189,000.00	2027-2029
Totali:	**210,000.00**			**21,000.00**		**189,000.00**	

Tabela 28. Furnizimi dhe instalimi i ujëmatësve të mençur (Smart)

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Furnizimi dhe instalimi i ujëmatësve të mençur (Smart)	55,000.00	Vetanake	100%	55,000.00	0%		2027-2028
Totali:	**55,000.00**			**55,000.00**			

Tabela 29. Investime në kyçjet individuale Komuna Gjilan dhe Kamenicë

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Kyçjet individuale në zonat rurale Bresalc, Ponesh, Komuna e Gjilanit	275,000.00	Komuna e Gjilanit, Qeveria, Donatorët	0%		100%	275,000.00	2027-2029
Ndërtimi i kyçjeve në sistemin e ujit të pijshëm për Fshati Karaçevë e Epërme, Komuna e Kamenicës	70,000.00	Komuna e Kamenicës, Qeveria, Donatorët	0%		100%	70,000.00	2027-2029
Totali:	**345,000.00**					**345,000.00**	

Tabela 30. Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në Komunën e Kllokotit

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në Komunën e Kllokotit, në vendbanimet Kllokot, Mogillë, Vërboc dhe Gërnçar	1,672,394.40	Qeveria, Donatorët	0%	0.00	100%	1,672,394.40	2027-2029
Totali:	**1,672,394.40**			**0.00**		**1,672,394.40**	

Tabela 31. Investime në rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit në zonat rurale Gjilan dhe Viti

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe realizimi i kyçjeve individuale në zonat rurale (Livoq i Epërm, Llashticë dhe Lladovë), Komuna e Gjilanit	850,000.00	Komuna e Gjilanit, Qeveria, Donatorët	0%		100%	850,000.00	2027-2029
Funksionalizimi i rrjetit të ujësjellësit për fshatrat Smirë dhe Vërban, Komuna e Vitisë	230,000.00	Komuna e Vitisë, Qeveria, Donatorët	0%		100%	230,000.00	2027-2029
Totali:	**1,080,000.00**			**0.00**		**1,080,000.00**	

Tabela 32. Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit - nivel regjional

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kyçjet individuale në	400,000.00	Komuna e Gjilanit, Qeveria,	0%		100%	400,000.00	2027-2029

Gjilan,Viti, Kamenicë		Donatorët					
Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit zona kufitare Gjilan – Novobërdë	620,000.00	Komuna e Gjilanit/Novobërdës, Qeveria, Donatorët	0%		100%	620,000.00	2027-2029
Totali:	**1,020,000.00**			**0.00**		**1,020,000.00**	

Tabela 33. Ndërtimi i rrjetit te ujësjellësit në zonat rurale në Komunat Kamenicë dhe Viti

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Busavatë, Komuna e Kamenicës	315,000.00	Komuna e Kamenicë, Qeveria			100%	315,000.00	2027-2029
Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe i kyçjeve individuale në fshatin Remnik, Komuna e Vitisë	485,000.00	Komuna e Vitisë, Qeveria			100%	485,000.00	2027-2029
Totali:	**800,000.00**			**0.00**		**800,000.00**	

Tabela 34. Ndërtimi i kolektorëve në fshatrat Përlepnicë, Dobërçan, Kmetoc, Shillovë

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Ndërtimi i kolektorëve në fshatrat Përlepnicë, Dobërçan, Kmetoc dhe Shillovë	630,000.00	Komuna e Gjilanit, Donatorët	0%		100%	630,000.00	2027-2029
Totali:	**630,000.00**					**630,000.00**	

Tabela 35. Investime në rrjetin Letnicë - Viti

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Ndërrimi i gypit të azbestit me diametër (fi) Ø 250 mm, nga FPU-ja deri te hyrja e Letnicës	100,000.00	Vetanake	100%	100,000.00	0%		2029
Rregullimi i kaptazhës te burimi mbi fshatin Letnicë, që furnizon FPU-në e Letnicës, si dhe instalimi i kabllove të rrymës nga shkolla deri te kaptazha, në gjatësi prej 400 m	100,000.00	Vetanake	100%	100,000.00	0%		2028
Totali:	**200,000.00**			**200,000.00**			

Tabela 36. Furnizimi me ujëmatës, bllokues dhe plomba për ujëmatës (investim për periudhën trevjeçare)

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Ujëmatës	140,000.00	Vetanake	100%	140,000.00	0%		2027-2029
Bllokues	5,000.00	Vetanake	100%	5,000.00	0%		2027-2029
Plomba per ujëmatës	5,000.00	Vetanake	100%	5,000.00	0%		2027-2029
Totali:	**150,000.00**			**150,000.00**			

Tabela 37. Blerja e pajisjeve fazonerike

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Investimi në blerjen e pajisjeve fazonerike për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit	150,000.00	Vetanake	100%	150,000.00	0%		2028-2029
Totali:	**150,000.00**			**150,000.00**			

Tabela 38. Investimet për sanimin e dëmeve të shkaktuara nga kushtet natyrore

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Investimet për sanimin e dëmeve të shkaktuara nga kushtet natyrore	60,000.00	Vetanake	100%	60,000.00	0%		2027-2029
Totali:	**60,000.00**			**60,000.00**			

Tabela 39. Sondë për matjen e parametrave fiziko-kimikë dhe bakteriologjikë

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Furnizimi me sondë për matjen e parametrave fiziko-kimikë dhe bakteriologjikë për të gjitha puset në zonën e shërbimit	400,000.00	Qeveria, Donatorët	0%		100%	400,000.00	2027-2029
Totali:	**400,000.00**					**400,000.00**	

Tabela 40. Investime në rehabilitimin dhe funksionimin e stacioneve të pompimit

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Zgjerimi i stacionit të pompimit dhe vendosja e dy pompave centrifugale në Zhegër, Gjilan	60,000.00	Qeveria, Donatorët	0%		100%	60,000.00	2027-2029
Ndërtimi i stacionit të ri të pompimit në Koretishtë, Gjilan	40,000.00	Qeveria, Donatorët	0%		100%	40,000.00	2027-2029
Funksionalizimi i puseve në lagjet Fidanishtja dhe Porodin, Gjilan	20,000.00	Qeveria, Donatorët	0%		100%	20,000.00	2027-2029
Totali:	**120,000.00**			0.00		**120,000.00**	

Tabela 41. Investime në sigurinë e burimeve të ujit në zonën e shërbimit që menaxhohen nga KRU "Hidromorava" sh.a. në Gjilan, Viti dhe Kamenicë viti 2023/2024 (të bartura nga viti 2024)

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Njësia Operative Gjilan	126,710.00	Qeveria, Donatorët	0%		100%	126,710.00	2027-2028
Njësia Operative Kamenicë	130,150.00	Qeveria, Donatorët	0%		100%	130,150.00	2027-2028
Njësia Operative Viti	14,545.00	Qeveria, Donatorët	0%		100%	14,545.00	2027-2028
Totali:	**271,405.00**					**271,405.00**	

Tabela 42. Investimi ne rrjetin e ujësjellësit në Beguncë, Komuna e Vitisë

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Investimi ne rrjetin e ujësjellësit në Beguncë	540,000.00	Qeveria, Donatorët	0%		100%	540,000.00	2027-2029
Totali:	**540,000.00**					**540,000.00**	

Tabela 43. Investimi në pajisje për detektimin e bllokimeve të rrjetit kanalizimit (të bartura nga viti 2024)

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Furnizim me kamerë dore për kontrollimin e gypave të kanalizimit (30-50m)	4,500.00	Vetanake	100%	4,500.00	0%		2027
Totali:	**4,500.00**			**4,500.00**			

Tabela 44. Investimi në blerjen e mjeteve të vogla të punës

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Investimi në blerjen e mjeteve të vogla të punës për ekipet e mirëmbajtjes së rrjetit të ujësjellësit në nivel regjional	15,000.00	Vetanake	100%	15,000.00	0%		2027
Totali:	**15,000.00**			**15,000.00**			

Tabela 45. Investimi në siguri në punë

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Pajisje personale mbrojtëse për punëtorët e terrenit	2,980.00	Vetanake	100%	2,980.00	0%		2027-2029
Totali:	**2,980.00**			**2,980.00**			

Tabela 46. Furnizimi me automjete për nevoja të Kompanisë

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Furnizimi me pesë vetura hibride	110,000.00	Vetanake	100%	110,000.00	0%		2027-2029
Furnizimi me një veturë elektrike (Divizioni prodhimit)	25,000.00	Vetanake	100%	25,000.00	0%		2027-2029
Furnizimi me një kombi (Divizioni i Mirëmbajtjes së Rrjetit të ujësjellësit)	15,000.00	Vetanake	100%	15,000.00	0%		2027-2029
Furnizimi me tri vetura	60,000.00	Vetanake	100%	60,000.00	0%		2027-

(4x4) për bartjen e punëtoreve për ekipet e ujësjellësit							2029
Furnizimi me pesë vetura Pick - up me ulëse	50,000.00	Vetanake	100%	50,000.00	0%		2027-2029
Totali:	**260,000.00**			**260,000.00**			

Tabela 47. Furnizimi me pajisje për detektimin e humbjeve të ujit nga rrjeti i ujësjellësit

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Furnizimi me pajisje për detektimin e humbjeve të ujit nga rrjeti i ujësjellësit, për identifikimin e defekteve që nuk shfaqen në sipërfaqe	40,000.00	Vetanake	100%	40,000.00	0%		2027-2028
Totali:	**40,000.00**			**40,000.00**			

Tabela 48. Furnizimi me një papuçe vibruese për ngjeshjen e trasesë

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Furnizimi me një papuçe vibruese për ngjeshjen e trasesë	40,000.00	Vetanake	100%	40,000.00	0%		2027-2029
Totali:	**40,000.00**			**40,000.00**			

Tabela 49. Investime në makineri në Gjilan, Viti, Kamenicë

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Furnizimi me një autocisternë me rezervuar 3.5 m^3, për tërheqje dhe zhbllokim	45,000.00	Vetanake	100%	45,000.00	0%		2027-2029

Furnizimi me dy cisterna për furnizim me ujë, me kapacitet 7-9 m^3	300,000.00	Vetanake	100%	300,000.00	0%		2027-2029
Furnizimi me dy kamionë 5-7-tonësh për adaptimin e cisternës së ujit	30,000.00	Vetanake	100%	30,000.00	0%		2027-2029
Furnizimi me një kamion 5-7-tonësh me vinç	50,000.00	Vetanake	100%	50,000.00	0%		2027-2029
Furnizim me kamionetë (kipper)	15,000.00	Vetanake	100%	15,000.00	0%		2027-2029
Furnizimi me një automjet të tipit kombi për debllokim	49,000.00	Vetanake	100%	49,000.00	0%		2027-2029
Furnizimi me dy ekskavatorë të vegjël, me peshë 5-7 tonë, me rrota gome.	250,000.00	Vetanake	100%	250,000.00	0%		2027-2029
Totali:	**739,000.00**			**739,000.00**			

Tabela 50. Furnizimi me mjete të IT-së

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
PC workstation (8 copë)	10,000.00	Vetanake	100%	10,000.00	0%		2027
PC (10 copë)	6,000.00	Vetanake	100%	6,000.00	0%		2027
Laptop (5 copë)	4,000.00	Vetanake	100%	4,000.00	0%		2027-2029
Printer MFP me kapacitet të lartë shtypjeje (5 copë)	5,000.00	Vetanake	100%	5,000.00	0%		2027
Kabllo UTP EconLine Cat 6 Class E, prizat RJ45, Patch Panel, Switch i menaxhueshëm 24 dhe 48 portë, Wi-Fi UniFi	8,000.00	Vetanake	100%	8,000.00	0%		2027-2029
Server brend Dell - HP	20,000.00	Vetanake	100%	20,000.00	0%		2027-2028

Microsoft office 365 Exchange 50 user (50 përdorues)	4,240.00	Vetanake	100%	4,240.00	0%		2027-2029
Mirëmbajtja e licencës së Firewall-it Fortinet për periudhë 3-vjeçare.	2,500.00	Vetanake	100%	2,500.00	0%		2027-2029
Furnizim me drum dhe pajisje harxhuese.	5,000.00	Vetanake	100%	5,000.00	0%		2027-2029
Furnizim me tonerë për periudhë 3-vjeçare.	18,000.00	Vetanake	100%	18,000.00	0%		2027-2029
Klimë ftohëse për dhomën e serverit në HO.	600.00	Vetanake	100%	600.00	0%		2027-2029
Pajisje për hyrje-dalje ANIVZ - W1C Pro.	1,000.00	Vetanake	100%	1,000.00	0%		2027-2029
Kamera sigurie, rek, DVR, kabllo etj., dhe pajisje përcjellëse.	250.00	Vetanake	100%	250.00	0%		2027-2029
GPS për automjete për periudhë 3-vjeçare	12,000.00	Vetanake	100%	12,000.00	0%		2027-2029
Kompjuter + monitor	1,000.00	Vetanake	100%	1,000.00	0%		2027-2029
Pajisje dore Android për ekipet e terrenit (Konsumatorëve, Shkyçjes, Operimit dhe Mirëmbajtjes dhe GIS).	15,000.00	Vetanake	100%	15,000.00	0%		2027-2029
Access Point - Wi-Fi 6 (802.11ax), indoor, dual-radio/dual-band, deri në 4 spatial streams, deri në 2.97 Gbps, 1×10/100/1000M BASE-T uplink + 1×1G/2.5G SFP uplink, PoE / local power, cloud management lifetime.	630.00	Vetanake	100%	630.00	0%		2027-2029
UTP dhe pjesët shtesë - Kabllo UTP Cat6/Cat6E: 7 kuti × 305 m (2,135 m); 3 × patch panel 48-portësh; module Keystone RJ45	3,300.00	Vetanake	100%	3,300.00	0%		2027-2029

Cat6; priza/faceplate modulare dhe kuti montimi; patch cords; cable managers; kanale PVC dhe aksesorë; etiketa, Velcro dhe material montimi në rack.							
Switch-at - 52-port Gigabit Layer 2 Cloud Managed PoE Switch: 48 × 10/100/1000Base-T Gigabit ports, 4 × 1GE SFP optical uplink slots, total PoE budget 370 W.	3,000.00	Vetanake	100%	3,000.00	0%		2027-2029
Instalimi - Shtrirja e kabllove, montimi i kanaleve dhe prizave modulare, terminimi në patch panel dhe prizë, testimi, etiketimi/shenjëzimi i kabllove, montimi i patch panel-eve, switch-eve dhe AP-ve.	1,500.00	Vetanake	100%	1,500.00	0%		2027-2029
Shërbim Cloud Backup për Microsoft SQL Server - Me kapacitet deri në 5 TB dhe mundësi zgjerimi të kapacitetit sipas rritjes së të dhënave dhe nevojave të institucionit, për ruajtjen e kopjeve rezervë jashtë objektit të institucionit. Zgjidhja duhet të mundësojë backup automatik direkt nga SQL Server-i në cloud, enkriptim dhe ruajtje të sigurt të të dhënave, politikë të përcaktuar të retention-it dhe mundësi të rikthimit të bazës së të dhënave në rast të humbjes, dëmtimit ose dështimit të serverit. Përfshihet licenca/shërbimi cloud,	1,500.00	Vetanake	100%	1,500.00	0%		2027-2029

konfigurimi, integrimi me SQL Server dhe testimi i backup-it dhe restore-it. Furnizimi dhe implementimi do të realizohen përmes operatorit ekonomik të përzgjedhur.							
Upgrade dhe konfigurimi i serverit GIS HP ProLiant DL360 Gen9 - Instalimi i 8 disqeve, zgjerimi i memories RAM nga 256 GB në 512 GB, konfigurimi RAID, instalimi, konfigurimi, testimi dhe vënia në funksion.	4,000.00	Vetanake	100%	4,000.00	0%		2027-2029
Sistem i kompletuar i mbikëqyrjes me kamera për objektin Penda e Përlepnicës - Përfshirë kamerat IP, NVR, pajisjet e ruajtjes së pamjeve për minimum 30 ditë, switch PoE dhe pajisjet përcjellëse, TV/monitorin për monitorim, kabllimin, instalimin, konfigurimin dhe testimin e plotë të sistemit. 8 kamera. Kapaciteti i ruajtjes dhe konfigurimi teknik do të përcaktohen në bazë të vlerësimit teknik të objektit dhe kërkesës për ruajtjen e pamjeve për minimum 30 ditë.	3,848.00	Vetanake	100%	3,848.00	0%		2027-2029
Sistem i kompletuar i mbikëqyrjes me kamera për objektin Baja - Përfshirë kamerat IP, NVR, pajisjet e ruajtjes së pamjeve për minimum 30 ditë, switch PoE dhe pajisjet përcjellëse, TV/monitorin për monitorim, kabllimin,	5,000.00	Vetanake	100%	5,000.00	0%		2027-2029

instalimin, konfigurimin dhe testimin e plotë të sistemit. 16 kamera. Kapaciteti i ruajtjes dhe konfigurimi teknik do të përcaktohen në bazë të vlerësimit teknik të objektit dhe kërkesës për ruajtjen e pamjeve për minimum 30 ditë.							
Sistem i kompletuar i mbikëqyrjes me kamera për objektin Velekincë - Përfshirë kamerat IP, NVR, pajisjet e ruajtjes së pamjeve për minimum 30 ditë, switch PoE dhe pajisjet përcjellëse, TV/monitorin për monitorim, kabllimin, instalimin, konfigurimin dhe testimin e plotë të sistemit. 8 kamera. Kapaciteti i ruajtjes dhe konfigurimi teknik do të përcaktohen në bazë të vlerësimit teknik të objektit dhe kërkesës për ruajtjen e pamjeve për minimum 30 ditë.	2,500.00	Vetanake	100%	2,500.00	0%		2027-2029
Sistem i kompletuar i mbikëqyrjes me kamera për objektin e KRU "Hidromorava" në Viti - Përfshirë kamerat IP, NVR, pajisjet e ruajtjes së pamjeve për minimum 30 ditë, switch PoE dhe pajisjet përcjellëse, TV/monitorin për monitorim, kabllimin, instalimin, konfigurimin dhe testimin e plotë të sistemit. 6 kamera. Kapaciteti i ruajtjes dhe konfigurimi teknik do të përcaktohen në bazë të	1,920.00	Vetanake	100%	1,920.00	0%		2027-2029

vlerësimit teknik të objektit dhe kërkesës për ruajtjen e pamjeve për minimum 30 ditë.							
Zhvillimi i aplikacionit për pajisje dore për lexim dhe i uebmodulit, aplikacioni për pagesa dhe call center.	100,000.00	Vetanake	100%	100,000.00	0%		2027-2029
Totali:	**239,788.00**			**239,788.00**			

Tabela 51. Shërbime profesionale të jashtme për përmbushjen e kërkesave ligjore dhe rregullative

Përshkrimi	**Çmimi**	**Burimet e Financimit**	**Përqindja e Financimit KRU**	**Vlera në €**	**Përqindja e Financimit Donatorët**	**Vlera në €**	**Viti Investimit**
Raporti i Kënaqshmërisë së Konsumatorëve (shërbim)	1,000.00	Vetanake	100%	1,000.00	0%		2027
Hartimi i Dokumentit të Riskut dhe Trajnimi i Punëtorëve	7,500.00	Vetanake	100%	7,500.00	0%		2027-
Totali:	**8,500.00**			**8,500.00**		**0.00**	

Tabela 52. Elaborate për leje ujore

Përshkrimi	**Çmimi**	**Burimet e Financimit**	**Përqindja e Financimit KRRU**	**Vlera në €**	**Përqindja e Financimit Donatorët**	**Vlera në €**	**Viti Investimit**
Elaborate për leje ujore	40,000.00	Vetanake	100%	40,000.00	0%		2027
Totali:	**40,000.00**			**40,000.00**		**0.00**	

Tabela 53. Dokumentacioni për kushte ndërtimore ITUZ

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Projekti elektroenergjetik për ITUZ	5,000.00	Vetanake	100%	5,000.00	0%		2027-2028
Elaborati për mbrojtje nga zjarri për ITUZ	5,000.00	Vetanake	100%	5,000.00	0%		2027-2028
Totali:	**10,000.00**			**10,000.00**		**0.00**	

Tabela 54. Hartim të projekteve për rrjet të ujësjellësit për investime ndërkombëtare

Përshkrimi	Çmimi	Burimet e Financimit	Përqindja e Financimit KRRU	Vlera në €	Përqindja e Financimit Donatorët	Vlera në €	Viti Investimit
Hartim të projekteve për rrjet të ujësjellësit për investime ndërkombëtare	20,000.00	Vetanak	100%	20,000.00	0%		2027
Totali:	**20,000.00**			**20,000.00**		**0.00**	

11. REKAPITULLIMI I PROJEKTEVE 2027 - 2029 NGA INVESTIMET E KRU HIDROMORAVA/DONATORË

Tabela 55. Rekapitullimi i investimeve vetanake për vitin 2027

	Vlera në Euro	Vlera në %
Vlera Totale e Investimeve ne infrastrukturë	11,769,299.40	89.24

	Vlera në Euro	Vlera në %
Vlera totale e investimeve në makineri-Mjete pune	1,101,480.00	8.35

	Vlera në Euro	Vlera në %
Vlera totale e investimeve në IT	239,788.00	1.82

	Vlera në Euro	Vlera në %
Vlera totale e Hartimit të dokumenteve	78,500.00	0.60

	Vlera në Euro
Vlera Totale e investimeve (Infrastrukture, Makineri-Paisje, IT)	13,189,067.40

Tabela 56. Investimet me mjete vetanake

Investimet me mjete vetanake	
Investimet Vetanake infrastrukturë	**3,494,400.00**
Investimet Vetanake Makineri-Mjete pune	**1,101,480.00**
Investime Vetanake IT	**239,788.00**
Hartimi i dokumenteve	**78,500.00**
Totali:	**4,914,168.00**

Tabela 57. Investimet në infrastrukturë

Investimet infrastrukturë me mjete vetanake 2027 - 2029	
Investimet Vetanake infrastrukturë 2027	**1,015,500.00**
Investimet Vetanake infrastrukturë 2028	**1,433,900.00**
Investimet Vetanake infrastrukturë 2029	**1,045,000.00**
Totali:	**3,494,400.00**

Tabela 58. Rekapitullimi i investimeve nga donatorët 2027-2029

Investimet infrastrukturë me donatorë 2027 - 2029	
Investimet donatorë infrastrukturë 2027-2029	8,274,899.40
Totali:	8,274,899.40

Bordi i Drejtorëve i KRU "Hidromorava" sh.a.

z. Habil Zeqiri
U.D. Kryesues i Bordit të Drejtorëve

Kompania Rajonale e Ujësjellësit
"Hidromorava"
Gjilan

Hidromorava Gjilan

PLANI I BIZNESIT
2027 - 2029



Kontakt

Vëllezërit Gërvalla, 71
60000 Gjilan
Republika e Kosovës

info@kru-hidromorava.com

0800 61 000

www.kru-hidromorava.com